

Hartëzimi i Organizatave Lokale dhe me Bazë në Komunitet

Implementuar nga:



INICIATIVA KOSOVARE PER STABILITET
KOSOVAR STABILITY INITIATIVE



Botues: GrassRoots Action Support – GRAS

Menaxher i projektit: Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS

Redaktor: Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS

Hulmtimi në terren: AnketaCo

Autor: Kushtrim Shaipi

Redaktimi teknik dhe dizajni: Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS

Shënim

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e "*Iniciativës Kosovare për Stabilitet*" dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

*Të gjitha të drejtat e rezervuara



PASQYRA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	1
1__SFONDI.....	1
1.2 Qëllimi dhe objektivat e hartëzimit.....	5
1.3 Metodologjia dhe mostra.....	6
1.3.1Kufizimet metodologjike dhe definicionet.....	10
2. __GJETJET	14
___2.1 Mjedisi zbatues.....	14
2.1.1 Korniza ligjore dhe institucionale.....	18
2.1.2 Shpërndarja dhe mbulueshmëria gjeografike.....	21
2.2 Gjendja aktuale e organizatave lokale dhe me bazë në komunitetet.....	22
2.2.1 Të kuptuarit e komuniteteve në kontekstin kosovar.....	22
2.2.2 Qeverisja dhe strukturat.....	24
2.2.3 Fokusi aktual i programeve.....	29
2.2.4 Përpjekjet avokuese dhe aktivizmi me bazë në komunitet.....	34
2.3 Planet për të ardhmen.....	44
2.3.1 Fokusi i synuar i aktiviteteve të ardhshme.....	46
2.4 Nevojat për zhvillimin e kapaciteteve.....	47
2.4.1 Ekspertiza dhe trajnimi.....	47
2.4.2 Zhvillimi institucional.....	48
3. __PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	51
___3.1 Përfundimet dhe rrjedha e sugjeruar e veprimt.....	51
BIBLIOGRAFIA.....	58
SHTOJCA 1: PYETËSORI 1.....	63
SHTOJCA 2: PYETËSORI 2.....	70
SHTOJCA 3: LISTA E ORGANIZATAVE TË INTERVISTUARA.....	72

PASQYRA E FIGURAVE

Figura 1: Përfaqësimi i OShC-ve aktive sipas rajonit	15
Figura 2: Pjesëtarët dhe komunitetet	23
Figura 3: Numri i anëtarëve të bordit sipas rajonit	24
Figura 4: Qeverisja: Kuvendi i Anëtarëve sipas llojit të organizatës	25
Figura 5: Shpeshësia e takimeve të kuvendit	26
Figura 6: Numri i stafit gjatë vitit të kaluar	27
Figura 7: Numri i vullnetarëve të angazhuar në vitin 2018	29
Figura 8: Fokusi aktual i programeve sipas rajonit	30
Figura 9: Anëtarësia në rrjete vendore apo ndërkombëtare sipas llojit të organizatës	31
Figura 10: Burimet aktuale të financimit	33
Figura 11: Vlera aktuale e portfolios së projekteve aktuale sipas llojit të organizatës	33
Figura 12: Numri i projekteve aktive sipas rajonit	34
Figura 13: Mënyrat e komunikimit të përdorura nga organizatat për qëllime të identifikimit të nevojave të komunitetit	35
Figura 14: Format e përfshirjes së komuniteteve në implementimin e projektit	36
Figura 15: Komunikimi lidhur me rezultatet dhe arritjet e projektit	36
Figura 16: Partneritetet me organizatat e tjera sipas rajonit	37
Figura 17: Takime me përfaqësues komunalë sipas llojit të organizatës	37
Figura 18: Monitorimi i komunave sipas rajonit	39
Figura 19: Dërgimi i letrave apo pyetjeve publike sipas rajonit	40
Figura 20: Pjesëmarrja në dëgjime publike sipas llojit të organizatës	40
Figura 21: Kënaqësia me përgjigjet ndaj kërkesave sipas rajonit	41
Figura 22: Kënaqësia me transparencën sipas rajonit	43
Figura 23: Kënaqësia me mbështetjen financiare sipas komunës apo rajonit	44
Figura 24: Posedimi i Planit Strategjik sipas rajonit	45
Figura 25: Posedimi i Planit të Qëndrueshmërisë sipas rajonit	45
Figura 26: Planet për aktivitetet e ardhshme	46
Figura 27: Planet për dyfishimin e aktiviteteve në zonat e tjera	47
Figura 28: Nevojat për formilimin/analizën e politikave lokale sipas llojit të organizatës	48
Figura 29: Nevojat për planifikim strategjik sipas rajonit	48
Figura 30: Adoptimi i teknologjive të reja	49
Figura 31: Menaxhimi dhe zbatimi sipas rajonit	50
Figura 32: Menaxhimi dhe zbatimi sipas llojit të organizatës	50

HYRJE

Ky raport ofron një pasqyrë të mjedisit zbatues të projektit GrassRoots Action Support – GRAS, një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe implementuar nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), Lens, dhe Friedrich Ebert Stiftung (FES), zyra në Kosovë. Raporti gjithashtu ofron një pasqyrë të kapaciteteve dhe nevojave të Organizatave të Shoqërisë Civile (OshC) të synuara me këtë hulumtim, gjegjësisht të organizatave me bazë në komunitet dhe atyre lokale. Duke qenë se nuk ekziston një nocion universal për t'i definuar organizatat me bazë në komunitet (grassroots), janë analizuar një sërë definicionesh para se të përzgjidhet ai të cilin e ofron Desku Online i Shoqërisë Civile të Bashkimit Evropian (BE), i cili përdorë shprehjet "vetëorganizim, interesa të përbashkëta, e bazuar në vullnetarizëm, organizata joprofitabile" si fjalë kyçe për të definuar organizata të tilla. Ngjashëm, për shkak të vështirësisë së përkthimit të fjalëve "*constituents*" dhe "*constituencies*" në gjuhën shqipe, gjatë intervistimit të organizatave, fjala "komunitet" dhe disa shprehje të tjera janë adoptuar si mënyra më e duhur për ta shpjeguar konceptin.

Mjedisi dinamik i OShC-ve kërkon përpjekje të vazhdueshme për t'i ruajtur dhe për t'i përditësuar veprimtaritë e OShC-ve, dhe aftësinë e tyre për t'u marrë me sfidat me të cilat këto organizata ballafaqohen në baza ditore. Për më tepër, ky mjedis kërkon përmirësime sistemore dhe ndryshime politike/legjislative të infrastrukturës ekzistuese për të krijuar mjedis më të favorshëm për aktivitetet e OShC-ve. Megjithëse cënimet dhe pengesat nga shteti thuajse nuk ekzistojnë, shumica e OShC-ve kanë raportuar nevojën për t'i shkallëzuar më tej aktivitetet e tyre dhe për të vazhduar të jenë organizata aktive.

Duke filluar nga OShC-të 'fillestare' (të regjistruara në dy vitet e fundit) e deri te organizatat të cilat kanë mbi një dekadë përvojë pune, grupi i OShC-ve të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre në nivel lokal është mjaft i llojllojshëm. Shumica e organizatave të anketuara kanë raportuar buxhet prej më pak se 100,000 euro në vit, duke treguar ndjeshmëri të theksuar financiare dhe mungesë të qëndrueshmërisë

OShC-të fillestare dhe organizatat e themeluara tash e një dekadë janë të ngjashme, kanë vështirësi financiare dhe qëndrueshmëri të ulët të aktiviteteve të tyre. Shumica e tyre kanë buxhet vjetor deri në 100,000 euro dhe portfolio prej 1-2 të projekteve aktive.

Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve është i nevojshëm për t'i ruajtur resurset humane profesionale brenda sektorit të shoqërisë civile për shkak të hyrje-daljeve të vazhdueshme të njerëzve nga ky sektor. Zhvillimi i kapaciteteve është gjithashtu i nevojshëm për t'i mbajtur njohuritë dhe shkathtësitë e përditësuara në nivel me trendet globale dhe zhvillimet e reja.

plane për aktivitete, por u nevojitet ndërtimi i kapaciteteve për t'i zbatuar ato në mënyrë efektive dhe efikase. Përkundër planeve dhe ideve për projekte në të ardhmen (ku hyjnë edhe përsëritja e projekteve të njehta në zona të tjera gjeografike, si dhe zhvillimi i projekteve të reja), rreth gjysma e organizatave nuk kanë plane strategjike. Aspektet e tjera të qëndrueshmërisë së organizatave (menaxhimi i njohurive, stafi, zhvillimi dhe zbatimi i procesit) janë të gjitha të prekura në masë të madhe nga mungesa e qëndrueshmërisë financiare.

Njëra prej pengesave më të mëdha të kapaciteteve që duhet tejkaluar ka të bëjë me aftësinë e organizatave të ruajnë staf të përhershëm me orar të plotë. Kjo është rrjedhojë e varësisë

financiare. Portfoliot e tyre aktuale të projekteve variojnë ndërmjet një (1) dhe disa projekteve, me një numër të konsiderueshëm organizatash të cilat kanë raportuar një (1) ose dy (2) projekte aktive. Aktualisht, shumica e OShC-ve raportojnë

nga financimi i bazuar në projekte, që është tipik për shumë organizata. Ato nuk janë në gjendje të krijojnë resurse humane, të grumbullojnë njohuri dhe shkathtësi, dhe

ta rrisin nivelin e veprimtarisë së tyre. Avokimi, formulimi i politikave dhe monitorimi janë aktivitete të vazhdueshme ditore të cilat kërkojnë vëmendje dhe përkushtim të vazhdueshëm. Kështu, ndërprerja e financimit si rrjedhojë prodhon mungesë burimesh njerëzore, si dhe mungesë të pjesëmarrjes së OShC-ve në procese. Andaj, procesi i dhënies së granteve dhe i zhvillimit të kapaciteteve për organizata lokale mbetet pjesë kyçe që së bashku me kapacitetet e nevojshme mëton t'i adresojë me sukses sfidat lokale. Derisa lëvizjet e stafit dhe bartja e ekspertizës nga një organizatë në tjetrën apo nga njëri sektor në tjetrin duhet parë si fakt, përpjekjet për ngritjet e kapaciteteve të tyre nuk duhen konsideruar të shkuara dëm. Përkundrazi, duhet konsideruar se zhvillimi i kapaciteteve ka prodhuar efekt me peshë edhe te sektorët e

Partneritetet ndërsektoriale thuajse nuk ekzistojnë në Kosovë dhe ato duhen promovuar si njëri prej trendeve më të popullarizuara globale. Përfshirja në zgjidhjen e problemit dhe angazhimi i sektorit privat janë thelbësore për adresimin e shumicës së sfidave me të cilat ballafaqohet Kosova si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror.

tjerë, të cilët gjithashtu kanë nevojë të madhe për burime njerëzore profesionale.

Mostra e përfituesve të mundshëm nga projekti GRAS është mjaft e larmishme për të lejuar fleksibilitet në dizajnimin e përkrahjes. Organizatat e synuara, për sa i takon madhësisë, përvojës, temave dhe sektorëve të mbuluar, si dhe, për sa u takon sektorëve, temave dhe prioritetëve, kanë një përbërje mjaft të llojllojshme.

Duke u nisur nga njohuritë e kufizuara të OShC-vë sa i takon procesit të aplikimit, vlerësimit dhe vendimmarrjes në thirrjet publike për aplikime, rekomandohet që gjatë seancave informuese për programet e ardhshme të dhënies së granteve të vihet fokus i veçantë në procesin e vlerësimit dhe ¹¹“Revitalizimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm” ka qenë Qëllimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm i cili ka marrë më së paku vëmendje.

Vullnetarizmi është aspekti tjetër kyç i punës dhe i angazhimit të organizatave lokale, sidomos ato të synuara nga projekti GRAS. Derisa shumica e organizatave raportojnë mungesë të mobilizimit të vullnetarëve për çështjet dhe aktivitetet e tyre, realisht shkaqet dhe çështjet rreth të cilave angazhohen OShC-të duhet të

t'u shpjegohet ky proces në hollësi, çka konsideron të rëndësishme komisioni vlerësues, njohuritë paraprake të vlerësuesve sa i përket një vargu të gjatë temash të mbuluara, etj.

Hisedarët nga sektori i tregtisë dhe industrisë (T&I) rrallëherë përfshihen nga OShC-të për të adresuar/avokuar për çështjet e tyre. Trendet globale sjellin partneritete ndërsektoriale dhe përfshirje të kapitalit privat për zgjidhjen e problemeve. Derisa T&I janë hisedarë kyçë me interes të theksuar dhe ndikim të madh, ata shpeshherë shpëfillen tërësisht nga OShC-të. Andaj, angazhimi i shtuar i sektorit privat (T&I) në aktivitete në të ardhmen duhet nxitur në veçanti brenda skemës së grantit

pasqyrojnë prioritetet e komuniteteve apo të qytetarëve. Andaj, angazhimi i vullnetarëve duhet nxitur në veçanti meqë kjo gjithashtu kontribuon në gjithëpërfshirjen e cila nevojitet aq shumë në mbarë sektorët në Kosovë. Vlerësimi me pika shtesë për organizatat të cilat kanë komponentën e angazhimit të vullnetarëve do ta rriste në masë të madhe ndikimin horizontal dhe shtrirjen e investimit të GRAS-it, duke krijuar kështu efekt të shumëfishuar me bazë në komunitet përgjatë sektorëve dhe temave.

¹¹ <https://www.un.org/sustainabledevelopment/blog/2015/03/integrating-resilience-and-sustainable-development/>

Për t'i adresuar njohuritë dhe vetëdijësimin relativisht të ulët të OShC-ve sa i takon Procesit të Anëtarësimit në BE, mekanizmave të Paraanëtarësimit që kjo fazë i sjellë, si dhe në përgjithësi në lidhje me Kornizën Politike Acquis të BE-së, rekomandohet fuqishëm të të mbështeten punëtoritë tematike sektoriale për të orientuar kontributin e OShC-ve në raportin e progresit të BE-së. Organizimi i grupeve punuese/punëtorive me OShC-të për temat që përcjellin strukturën e Raportit të Progresit do t'i fuqizonte në masë të madhe përpjekjet avokuese në nivel lokal dhe nacional, dhe do t'i shumëfishonte sinergjitë ndërmjet nismave të ndryshme. Aktualisht, konsultimet me shoqërinë civile të lehtësuara nga Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë rëndom

përfshijnë një numër të vogël organizatash, kryesisht nga kryeqyteti.

Sa i përket zhvillimit të kapaciteteve, është identifikuar nevoja si për trajnime të përgjithshme ashtu edhe për ato teknike. Shumica e organizatave të synuara nga projekti GRAS do të përfitonte nga zhvillimi i kapaciteteve dhe bartja e njohurive sa i takon zhvillimit të projekteve, menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit, si dhe sa i përket planifikimit strategjik afatmesëm dhe mbledhjes së fondeve. Për sa u takon trajnimeve teknike, zhvillimi i kapaciteteve për formulim të politikave dhe monitorim janë identifikuar si të nevojshme. Edhe shkathtësitë hulumtuese janë parë si të mangëta tek organizatat, dhe ato duhen adresuar për të rritur nivelin e efikasitetit dhe të efektivitetit në aktivitetet e tyre avokuese.

1.1 Sfondi i hartëzimit

Ky Hartëzim u realizua nga AnketaCo përmes projektit të financuar nga Bashkimi Evropian, të imlementuar nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet, si pjesë e projektit GRAS. Objektiva kryesore e hartëzimit ka qenë ta informojë IKS-në dhe partnerët e saj të projektit, LENS-in dhe Zyrën e Fondacionit Friedrich Ebert, zyra në Kosovë (FES), për të zhvilluar mbështetje të duhur dhe për ta përshtatur këtë mbështetje ndaj audiencës së synuar të OShC-ve lokale dhe të bazuara në komunitet. Kështu, hartëzimi ka provuar të ketë edhe një pamje të situatës (prioritetet dhe nevojat) në terren, dhe të identifikojë plane (prioritetet dhe nevojat) për periudhën e ardhshme.

Perspektiva e ardhshme që ky raport përmbanë është e orientuar drejt rezultateve dhe fokusohet në identifikimin e duhur të pengesave dhe sfidave, si dhe të mundësive për adresimin e tyre, me qëllim të krijimit të një mjedisi dinamik dhe të përshtatshëm i cili promovom kulturë angazhuese tek OShC-të dhe publiku në përgjithësi.

IKS ka punuar nga afër me partnerët e projektit për të përcaktuar qasjen metodologjike, instrumentet dhe mostrat e duhura, si dhe

implementimin aktual të punës. Kontributi dhe mbështetja e të gjithë hisedarëve, e cila ishte kyçe për përmbylljen e suksesshme të kësaj detyre është për t'u vlerësuar.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e hartëzimit

Objektiva kyçe e këtij hartëzimi është të identifikohen nevojat dhe prioritetet aktuale për mbështetje të OShC-ve për të krijuar një mjedis të përshtatshëm i cili nxit aktivizmin e shoqërisë civile lokale. Detyra kryesore në këtë aspekt është të sigurohen dhe të paraqiten objektivisht informacionet mbi situatën e sektorit të OShC-ve, që kanë të bëjnë me shtrirjen e OShC-ve dhe me kornizën ligjore që e rregullon këtë sektor; Kapacitetet dhe nevojat e OShC-ve për t'u angazhuar në dialog të politikave; dhe Identifikimi i fushave për përmirësim, duke përfshirë sfidat me të cilat ballafaqohen organizatat dhe nevojat për ndërtim kapacitetesh. Në veçanti, qëllimi i këtij aktiviteti është:

- a) Të bëjë hartëzimin e OShC-ve dhe të lidhjeve të tyre si me institucionet nacionale ashtu edhe me partnerët e tyre zhvillimorë, duke përfshirë edhe analizën e pjesëmarrjes së OShC-ve në proceset zhvillimore dhe të bashkëpunimit, si dhe formulimin e rekomandimeve në fushat të cilat

- duhen përmirësuar për t'u mundësuar organizatave të luajnë rolin e tyre në mënyrë më aktive;
- b) Të identifikojë organizata dhe struktura kryesore të shoqërisë civile si dhe pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen ato sa i përket ofrimit të shërbimit, avokimit, dialogut të politikave dhe rrjetëzimit;
 - c) Të identifikojë fushat për përmirësim, strategji për ndërtim të kapaciteteve dhe qëndrueshmëri të OShC-ve, dhe të përgatisë një udhërrëfyes për një shoqëri civile më të strukturuar dhe për pjesëmarrje efektive të OShC-ve në dialog të politikave dhe në procese të zhvillimit të qëndrueshëm.
 - d) Të hartohet lista e OShC-ve aktive dhe një listë e ndarë e organizatave lokale dhe me bazë në komunitet nga lista e përgjithshme e OShC-ve aktive në Kosovë.

1.3 Metodologjia dhe mostra

Analiza e të dhënave dhe të databazave ekzistuese² të organizatave për të identifikuar trende, shabllone dhe supozime bazike, është zhvilluar qysh në fillim për t'i definuar

më qartë instrumentet dhe mostrat e kërkimit. Triangulimi është përdorur si qasje e analizës për të bërë diferencimin e burimeve të informacioneve dhe rrjedhimisht edhe të qëndrimeve dhe mendimeve të nëngrupeve dhe të kategorive të ndryshme brenda audiencës së synuar. Konsultimi i politikave (strategji relevante, ligje, dokumente të planifikimit etj.) u realizua gjithashtu paralelisht me vlerësimin e të dhënave. Burimet e statistikave zyrtare dhe raporteve gjithashtu u shikuan me qëllim të vlerësimit gjithëpërfshirës të mjedisit implementues. Intervistat e thukta me hisedarë relevantë gjithashtu u zhvilluan pas përfundimit të vlerësimit fillestar të informacioneve dytësore dhe të skenarëve bazikë. Kjo qasje siguron që rekomandimet e dhëna në raportin final të jenë të pranueshme dhe të paraqesin vështrime përfshirëse, duke rritur kështu pronësinë rreth rekomandimeve të cilat përfshihen aty.

Madhësitë e mostrave dhe metodologjia e marrjes së mostrave

Hulumtimi përfshin dy mostra të dy anketave:

- 1) Anketa e parë për vlerësimin e nevojave të OShC-ve përfshinë

² Databaza e OJO-ve të regjistruara, dhe informacione tjera të papërpunuara prej burimeve dytësore si tabela e rezultateve për dymbëdhjetë vitet e fundit të indeksit të shoqërisë civile nga USAID, Kosovë.

anketat e zhvilluara me gjithsej shtatëdhjetë (70) organizata³. Kjo anketë u hartua dhe u ndërmor për të marrë një pasqyrë të përgjithshme të OShC-ve lokale dhe me bazë në komunitet për sa i përket funksionalitetit, strukturës qeverisëse, aktiviteteve programore, burimeve dhe nevojave të organizatave. Mostra është përzgjedhur në mënyrë rastësore nga databaza e të gjitha nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë (9.285) OJQ-ve të regjistruara pranë Departamentit për OJQ, të Ministrisë së Administratës Publike. Mostra u përzgjedh përmes procedurës dyhapëshe. Në hapin e parë, organizatat të cilat nuk e plotësonin përshkrimin e përgjithshëm të nocionit *grassroots*, u hoqën nga lista e të anketuarve potencialë. Hapi i dytë ishte përzgjedhja rastësore e organizatave nga grupi i mbetur i pjesëmarrësve të kualifikueshëm për anketë. Pas aplikimit të një sërë filtrash fillestarë (aktivitetet, temat, mbulueshmëria, etj.) për të mënjanuar organizatat të cilat dukshëm nuk janë organizata

lokale⁴/të bazuara në komunitet, u nxor një listë prej një mijë (1000) organizatash të regjistruara nga e cila u përzgjedhën të anketuarit duke përdorur metoda të standardizuara për përzgjedhje rastësore të të anketuarve/organizatave.

- 2) Një anketë plotësuese vetëm me pyetje specifike në lidhje me komunitetet dhe mënyrat se si OShC-të ndërveprojnë me komunitetet e tyre është kryer gjithashtu. Mostra për këtë anketë shtesë u zgjerua nga shtatëdhjetë (70) në katërqind e pesë (405) organizata, duke përfshirë edhe ato që janë intervistuar në raundin e parë. Treqind e tridhjetë e pesë (335) organizata u përzgjedhën përveç shtatëdhjetë (70) organizatave që tashmë ishin përzgjedhur në anketën e parë pasi u ridizajnuar popullimi i OShC-ve të përdorura për anketën fillestare. Databaza e ridizajnuar përfshinë një listë prej një mijë e pesëqind (1500) organizatash që dolën të ishin aktive gjatë verifikimit të statusit të

³ Pas projektimit, ekipi hulumtues hoqi shtatë pyetësorë nga analiza, për shkak të cilësë së kompletimit. Rezultatet e prezentuara në këtë raport kanë të bëjnë me 63 organizata të cilat e kanë kompletuar anketën me cilësi të kënaqshme.

⁴ P.sh federatat sportive, asambletë komunale, klubet sportive, institutet, organizatat think tanks, etj

organizatës përmes hartëzimit të shpjeguar në vijim.

- 3) Hartëzimi kishte për qëllim të identifikonte dhe të krijonte një listë të OShC-ve aktive, duke përfshirë edhe një listë të ndarë organizatash të klasifikuara si lokale dhe me bazë në komunitet sipas definicionit të paracaktuar gjatë hulumtimit. Databaza e DOJQ-së u përdor si burimi i parë kundrejt të cilit u aplikuan një numër filtrash dhe verifikimesh për të dy qëllimet. Një listë ekzistuese e OShC-ve aktive me më shumë se një mijë (1000) OShC e hartuar nga LENS-i përmes një aktiviteti të ngjashëm në vitin 2015 u përdor si pikënisje, duke marrë parasysh se ishte i vetmi burim në dispozicion për këtë hartëzim. Përveç kësaj, një listë e re prej dyqind e pesëdhjetë (250) OShC-ve aktive e hartuar nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) në vitin 2018 u përdor gjithashtu për të përjashtuar procesin e verifikimit për këtë grup organizatash pasi që statusi i tyre aktiv ishte i njohur, ndërsa verifikimi për to është bërë vetëm nëse ndonjëra prej tyre klasifikohet si organizatë me bazë në komunitet. Hapat e tjerë

përfshijnë: largimi i orgnizatave që në mënyrë të qartë nuk ishin lokale/me bazë në komunitet, që nuk e plotësojnë përshkrimin e përgjithshëm të organizatave lokale sipas këtij hulumtimi, kontrollimi i uebfaqeve të OShC-ve dhe prania e tyre në media sociale, dhe kontaktimi i organizatave në mënyrë direkte për të verifikuar statusin e tyre. Një kontroll tjetër u realizua përmes Sistemit Online të Administratës Tatimore të Kosovës për të gjitha organizatat të cilat nuk janë përgjigjur fare, pas tri përpjekjeve për t'i kontaktuar. Rezultatet e këtij aktiviteti përfshijnë: 1) një listë organizatash aktive me gjithsej tremijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë (3276) organizata, dhe 2) një listë të ndarë organizatash lokale dhe me bazë në komunitet, me gjithsej një mijë e dyqind e pesëdhjetë (1250) organizata.

Duke marrë parasysh sfidën e vështirë të cilën shumë akterë në Kosovë u përpoqën ta adresojnë, mund të thuhet se lista e organizatave aktive që doli nga ky aktivitet është lista më gjithëpërfshirëse që është bërë deri më sot, derisa lista e organizatave lokale dhe me bazë në komunitet

është e para e këtij lloji. Sidoqoftë, saktësia e të dhënave të paraqitura do të jetë proces i vazhdueshëm përgjatë këtij aktiviteti duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e këtij aktiviteti dhe ndryshueshmërinë e sektorit të OShC-ve me kalimin e kohës.

Një prej vështirësive më të mëdha për zhvillimin e anketave ka qenë saktësia e të dhënave në databazën e OJQ-ve të regjistruara. Shumë organizata nga databaza nuk ishin të qasshme për shkak të informacioneve të vjetëruara në këtë databazë⁵. Për të siguruar rastësi në përzgjedhjen e organizatave, OShC-të të cilat nuk ishin të qasshme u zëvendësuan me organizatat pasuese në listë, duke ruajtur kështu rregullin e përzgjedhjes së rastësishme. Për të siguruar se OShC-të janë aktive dhe implementojnë aktivitete, ekipi hulumtues ka përdorur gjithashtu databazat e programeve të kaluara dhe të tanishme të granteve⁶ për të identifikuar dhe për të kontaktuar organizatat për këtë anketë. Çështjet e tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e anketës shtesë lidhen me mungesën e të kuptuarit e OShC-ve të konceptit të komuniteteve, dhe fakti se të dhënat e ofruara raportohen nga ato vetë dhe mund të jenë të njëjshme.

Çështjet më të spikatura të cilat u hasën gjatë aktivitetit të hartëzimit janë:

- Pasaktësia e të dhënave në aspektin e të dhënave kontaktuese;
- Pamundësia për të kontaktuar me një numër organizatash, ose për arsye se numrat e kontaktit nuk ishin aktivë, pronari i numrit kishte ndryshuar, ose nuk kishte përgjigje fare në ato numra;
- Ndryshimi i formës fillestare të regjistrimit të organizatave (p.sh. nga fondacione në biznese);
- Profilet e padefinuara të organizatave, fushëveprimtaria dhe llojllojshmëria e aktiviteteve;
- OShC-të nuk janë çrregjistruar nga DOJQ-ja por të cilat nuk kanë buxhet e as projekte aktive për vite me radhë;

⁵ Personat kontaktues, informacionet e kontaktit, organizatat jofunksionale

⁶ Organizatat të cilat në mënyrë aktive kërkojnë fonde (aplikimet për fonde) përfaqësojnë dëshminë më të saktë rreth statusit të tyre aktiv

1.3.1 Kufizimet metodologjike dhe definicionet

Ka shumë mospajtime në debatet akademike për Shoqërinë Civile, Organizatat e Shoqërisë Civile, Organizatat Joqeveritare (OJQ), Organizatat Grasroots, dhe ka një mospajtim të madh edhe në definicionet e tyre. Kur shoqëria civile organizohet dhe strukturohet, ajo bëhet organizatë e shoqërisë civile (CSO). Përkundër faktit se konceptet 'shoqëria civile' dhe 'OShC' shpesh përdoren si sinonime, ka një dallim thelbësor ndërmjet këtyre dy koncepteve, të cilat shumëkush nuk i kupton. OShC-të përkufizohen si shoqëri civile e organizuar dhe mund të jenë të formave të ndryshme, disa joformale e të tjera entitete formale siç janë OJQ-të, Organizatat me Bazë në Komunitet, Organizatat Fetare, dhe shumë të tjera. Kjo është në rastin kur një grup individësh bëhen bashkë për një qëllim të përbashkët dhe përmbushjes së një mandati të caktuar të nxitur nga nevoja.

OShC-të duhet të kenë komunitet, meqë ato kanë përfitues të cilëve u shërbejnë dhe në rastin ideal i përfaqësojnë. Sidoqoftë, për të diskutuar për organizatat me bazë në

komunitet, duhet filluar me një koncept më të gjerë, e që është shoqëria civile e cila ka marrë vëmendjen në vitet 1980 (Gellner, 1994), megjithëse një numër i madh organizatash pretendon ta përfaqësojë këtë koncept. Duke qenë koncept i gjerë, nuk ka pajtueshmëri ndërmjet komunitetit akademik dhe profesionistëve në lidhje me atë se kush në të vërtetë i përket kësaj kategorie. Por, në disa kontekste koncepti i shoqërisë civile ende gëzon domethënie të gjerë në diskutime politike, andaj edhe mbulon një varg të gjerë akterësh për të përfshirë gjithçka që formalisht nuk ishte pjesë e shtetit, në disa raste edhe korporata shumëkombëshe, derisa në raste të tjera koncepti ngushtohet në një numër të vogël organizatash që përfaqësojnë vetëm grupe fushatash me pak ndikim në shoqëri. Përpjekja për ta definuar shoqërinë civile është një problem në vete kur diskutohet për shoqërinë civile.⁷ Por, ka shumë mospajtime dhe argumente normative të cilat i përcjellin diskutimet politike mbi shoqërinë civile.

⁷ <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK459047/>

Disa prej përkufizimeve më të spikatura të Shoqërisë Civile paraqiten në vijim:

shteti". 'As shteti as tregu' për të cilin pajtohen intelektualët publikë që dallojnë shumë nga njëri-tjetri si Jürgen

"organizatat e shoqërisë civile" si të gjitha format e grupimit apo grumbullimit që përfshijnë qytetarë, formale e joformale, që karakterizohen me: autonomi, asocim të lirë dhe vullnetar, pavarësi nga familja, joprofitabile, jashtë "institucioneve politike", me përqejësi shoqërore dhe leqjitime" (Costantini, G. Geetanjali G, 2013)

Definicioni i Bankës Botërore thotë: "Koncepti shoqëria civile ka të bëjë me një grup të gjerë organizatash joqeveritare dhe joprofitabile të cilat gëzojnë prani në jetën publike, shprehin interesat dhe vlerat e pjesëtarëve të tyre apo të të tjerëve në bazë të elementeve etike, kulturore, politike, shkencore, fetare e filantropike. OShC-të kësisoji kanë të bëjnë me një rrjet të gjerë organizatash: grupe të komunitetit, OJQ-të, sindakatat e punëtorëve, grupet indigjene, organizatat bamirëse, organizatat religjioze, shoqatat profesionale, dhe fondacionet".⁸

Thelbi i një definicioni të shoqërisë civile gjendet në Eur-lex: "Shoqëria civile ka të bëjë me të gjitha format e veprimtarisë sociale që realizohet nga individët apo grupet të cilat nuk janë as të lidhura as të drejtuara nga

Habermas dhe Jeanne Kirkpatrick, përfshin në njëfarë mënyre domethënien e shoqërisë civile, por është vështirë të shkohet tutje pa karakteristika të tjera përkufizuese. Çështja me këto dy definicione është se ato ose e përjashtojnë një pjesë të madhe të shoqërisë civile ose përfshijnë më tepër shoqëri. Një përkufizim i Peter Gundelachit nga Universiteti Aarhus i definon organizatat grassroots si "Organizata politike lokale të cilat mëtojnë të ndikojnë në rrethana të cilat nuk kanë të bëjnë me gjendjen e punës së pjesëmarrësve dhe të cilat e kanë aktivitetin e pjesëmarrësit si burimin e tyre parësor".⁹

Një definicion tjetër i përdorur nga Janis Foster në blogun e saj profesional thotë se *grassroots* "nënkupton njerëz të cilët bëhen bashkë duke pasur diçka

⁸https://caribbeanbritishcouncil.org/sites/default/files/assessment_of_civil_society_organizations_in_jamaica.pdf

⁹ Peter Gundelach. Grass Roots Organizations. Research Note. *Acta Sociologica* Vol. 22, No. 2 (1979), pp. 187-189. Sage Publications, Ltd Gjendet në: https://www.jstor.org/stable/4194291?newaccount=true&read-now=1&seq=1#page_scan_tab_contents

të përbashkët, që ka pasoja edhe personale edhe të komunitetit, dhe që u jep atyre autoritet ta zgjidhin problemin me të cilin ballafaqohen për të krijuar një të ardhme që ata e dëshirojnë¹⁰

Definicioni i shoqërisë civile gjithashtu varet nga konteksti në të cilin paraqitet. Duke qenë se projekti GRAS planifikon t'i ketë për synim organizatat që marrin pjesë në hartimin e politikave në sektorë të ndryshëm, organizatat me bazë në komunitet do t'i konsiderojmë ato që angazhohen në kultivimin e stabilitetit dhe të performansës demokratike. Në një rast të tillë, shoqëria civile shihet si 'hapësira publike ndërmjet shtetit dhe qytetarëve publikë' e cila ndërtohet mbi nevojën për t'u organizuar duke u nisur nga 'zhvillimi i bashkëpunimit dhe besimit ndërmjet qytetarëve'. Që marrëdhënia e tyre në demokracinë politike të përfaqohet, OShC-ja duhet të shpërfaqë karakteristikat në vijim: strukturë demokratike, 'autonomi dhe pluralitet organizativ, bazë të gjerë të popullarizuar, dhe rekrutim të hapur për anëtarësi' (Hadenius, A. and Ugla, F.1996).

Në anën tjetër, ngushtimi i definicionit për t'iu referuar vetëm organizatave

me bazë në komunitet bëhet edhe më i vështirë meqë nuk ka një kuptim të përbashkët dhe të përgjithshëm apo të paktën perceptim të përbashkët se kush me të drejtë i takon këtij grupi. Në të shumtën e rasteve, publiku i identifikon ato si "organizata joqeveritare", apo "bamiçese", derisa në raste të tjera, ato definojnë si "të gjitha organizatat që nuk lidhen me qeverinë apo me tregun"¹¹.

Përveç shoqatave profesionale dhe rrjeteve, ky hulumtim nuk ka arritur të zbulojë rrënjë të qëndrueshme të shumicës së organizatave të shoqërisë civile brenda komuniteteve të tyre, duke u munguar kësajsoji njëri prej veçorive përkufizuese të organizatave me bazë në komunitet. Një arsye për këtë shprehje është rezultat i presionit për të qenë jopolitikë, presion me të cilin ballafaqohen për të qenë llogaridhënës përpara donatorëve e jo përpara përfituesve, si dhe fokusi i tyre në projekte afatshkurtë se sa në ndryshime të strukturuar afatgjate (Fowler, 2000a, 2000b; Lang, 2013; Mohan, 2002). Këto presione u kanë lejuar atyre të shkëlqejnë në ofrimin e shërbimeve në kurriz të funksionit të shoqërisë civile.

¹⁰ Janis Foster Professional Blog, What do we mean by Grassroots, available at: <http://www.janifoster.com/2009/10/what-do-we-mean-by-grassroots.html>

¹¹ 2006, *The Civil Society Index Study Republic of Mauritius*, MACOSS.

Derisa nuk mëtojmë ta zgjidhim çështjen pa përgjigje të përkufizimit të organizatave me bazë në komunitet e që në njëfarë mënyre pasqyron llojllojshmërinë që ekziston brenda tyre, besojmë se diferencimi ndërmjet OJQ-ve dhe organizatave të shoqërisë civile të bazuara në anëtarësi është diferencimi kyç që duhet bërë për t'i mundësuar GRAS-it t'i fokusojë burimet e projektit në grupin e qartë të

synuar të përfituesve. Megjithëse edhe ky definicion është i gjerë, hulumtimi vjen në përfundim se definicioni sipas të cilit "*Organizata me bazë në komunitet është grup i vetëorganizuar individësh që punojnë për interesa të përbashkëta përmes një organizimi vullnetar, joprofitabil*" (Anheier, H./List, R., 2005) është më i afërti për ta përshkruar audiencën e cila synohet me projektin GRAS.¹²

¹² <https://webgate.ec.europa.eu/fpf/>

2.1 Mjedisi zbatues

Të dhënat e gushtit të vitit 2018 tregojnë se rreth nëntë mijë e katërqind (9.400) organizata lokale joqeveritare dhe rreth pesëqind e tridhjetë (530) degë të organizatave ndërkombëtare janë të regjistruara formalisht pranë Departamentit për Regjistrimin e Organizatave Joqeveritare (DOJQ) të Ministrisë së Administratës Publike¹³. Derisa regjistrimi i OJQ-ve është punë relativisht e lehtë e cila deri në një pikë kryhet online, mbyllja e organizatës nuk është e definuar aq qartë. Si rrjedhojë, një numër i konsiderueshëm në databazën e OJQ-ve është joaktiv, joekzistues, apo informacionet në lidhje me ato janë të pasakta. Vetëm në disa raste, aktiviteti/regjistrimi i një organizate u ndërpre (dhe më vonë u mbyll) dhe kjo kishte të bënte me organizata të cilat dyshoheshin për lidhje me ekstremizëm të dhunshëm dhe grupe radikale¹⁴ dhe me organizata të cilat rrezikonin rendin kushtetues në Kosovë¹⁵. Përveç këtyre, nuk ka të dhëna zyrtare për rastet e çregjistrimit të organizatave apo të shpërbërjes së tyre nga institucionet shtetërore.

Sipas këtij hulumtimi, tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë (3276) OJQ janë identifikuar si aktive në Kosovë. Nuk ka dallim të qartë ndërmjet organizatave joaktive në databazën e OJQ-ve të regjistruara, por dëshmitë nga burimet e tjera tregojnë se rreth një e treta e organizatave të regjistruara kanë marrë/kanë kërkuar fonde nga donatorë të ndryshëm dhe kanë qenë aktive rishtazi.

Nëse shikohet përfaqësimi aktiv i OShC-ve sipas rajonit, Prishtina është rajoni me numrin më të madh të OShC-ve aktive, derisa rajonet tjera janë të përfaqësuara ngjashëm me njëri-tjetrin. Ndërsa, nëse shikohet periudha e regjistrimit të OShC-ve, rreth 80% e OShC-ve aktive sipas këtij raporti janë të regjistruara ndërmjet viteve 2008 – 2018, derisa vetëm 20% kanë mbetur aktive që nga periudha e regjistrimit të tyre ndërmjet viteve 1999 – 2007. Këto shifra tregojnë se një numër i madh i OShC-ve të

Mjedisi që pengon aktivizmin ku sfera publike është e monopolizuar nga politikat ditore dhe e kushtëzuar nga rivaliteti politik për t'i dominuar çështjet e politikës së lartë.

¹³ Databaza e organizatave lokale dhe ndërkombëtare të regjistruara

¹⁴ OJQ-të të cilat promovojnë ekstremizmin nuk janë të lejuara të veprojnë. Radion Free Europe/Radion Liberty. <https://www.evropaelire.org/a27550186.html>

¹⁵ Ministria e Administratës Publike. DOJQ. Vendimi 06/097/2017 për suspendimin e aktivitetit të Airsoft Club Kodiac. <https://maprks-gov.net/getattachment/4705fd74-a4cd-4518-9644-afa12f0ee875/Vendim-11.aspx> dhe Vendimi 06/096/2017 për suspendimin e aktivitetit të Airsoft Club Vukovi. <https://maprks-gov.net/getattachment/fef1b4f-6a69-4c84-95d0-3d6c95fd45de/Vendim.aspx>

regjistruara në vitet e mëhershme kanë pushuar së funksionuari.

Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Pejës	Rajoni i Prizrenit	Rajoni i Mitrovicës	Rajoni i Gjilanit
48.02%	11.87%	11.96%	11.29%	13.79%

Figura 1: Përfaqësimi i OShC-ve aktive sipas rajonit

Në Kosovë, nocioni Organizata Joqeveritare përdoret për të definuar edhe Fondacione edhe Asociacione me anëtarësim, dy forma të vetme ligjore të organizatave për këto entitete në bazë të Ligjit për Lirinë e Asociimit. Shumë organizata donatorësh e përdorin shprehjen OJQ dhe OShC duke e zëvendësuar njëra-tjetrën, por kjo e fundit përfshin një grup më të gjerë organizatash, entitetesh dhe grupesh. Në shumw raste, forma ligjore e përvetësuar nga OJQ-të ka qenw më shumë uniforme dhe një vendim ad-hoc i themeluesve kur janë regjistruar.

Qëndrueshmëria e organizatave të shoqërisë civile në masë të madhe varet nga fondet në dispozicion. Në këtë aspekt, shumë prej OShC-ve aktive i kanë diversifikuar burimet e

financimit, dhe nganjëherë kanë përfshirë edhe burime vetanake të të hyrave nga shërbimet, qiraja, anëtarësia apo forma të tjera të hyrash, por ato nuk janë në gjendje ta realizojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur¹⁶. Kjo vlenw sidomos për institutet kërkimore (*think-tank*) dhe organizatat për demokraci dhe të qeverisje. Shumë organizata me anëtarësi pranojnë pagesa (së paku pjesërisht) nga anëtarët e tyre. Për organizatat me anëtarësi, kjo përbën pjesën më të madhe të të hyrave të tyre, megjithëse ato gjithashtu kërkojnë fonde nga burimet e jashtme për aktivitetet e tyre¹⁷. Organizatat rrallëherë presin mbështetje vullnetare pa pagesë nga komunitetet e tyre, meqë ato zakonisht nuk ia dalin të ndërtojnë komunitete në mënyrë efektive¹⁸. Një numër i madh organizatash kërkon financim nga burimet lokale filantropike, dhe shfrytëzon aktivitete mobilizuese, siç janë ngjarjet sportive apo festivalet kulturore për të nxjerrë fonde. Sipas Indeksit Botëror të Donacioneve 2017, 41 për qind e të anketuarve në Kosovë kanë raportuar të kenë dhënë donacione për bamirësi në vitin 2016. Një numër organizatash gjithashtu

¹⁶ USAID Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile 2016.

¹⁷ USAID Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile 2017.

¹⁸ Definicioni nga Merriam-Webster Dictionary, sipas të cilit ekzistojnë dy domethënie të aplikueshme: a) grupi apo trupi i cili përkrah, mbështet, apo ofron përfaqësim duke krijuar grup grass-roots për vazhdimin e projektit-Fred Reed; dhe b) njëritë e përfshirë apo të cilëve u shërben një organizatë (siç është biznesi apo institucioni) ...I sheh konsumatorët e vet të organizatës si grupe primare. - Andrew Hacker. Gjetet në: <https://merriam-webster.com/dictionary/constituency>

shfrytëzojnë platforma financimi nga popullata (*crowdfunding*) për aktivitetet e tyre.

Komisioni Evropian dhe USAID-i janë dy burime më të mëdha të financimit ndërkombëtar për organizatat në Kosovë; Agjencia Suedeze e Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SDC), Agjencia Gjermane për Zhvillim GIZ, Lux-Development, Norwegian Development Assistance, dhe programet e tjera dypalëshe gjithashtu përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kontributit ndërkombëtar të

Komisioni Evropian dhe USAID-i janë dy burimet më të mëdha të financimit ndërkombëtar për organizatat e Kosovës; programet e tjera dypalëshe apo shumëpalëshe donatorësh gjithashtu përbëjnë pjesën e konsiderueshme të kontributit të donatërve ndërkombëtarë në Kosovë. Institucionet publike gjithashtu përbëjnë burim të konsiderueshëm financimi për OShC-të me gjithsej 28 milionë euro për periudhën 2014-2015,

donatorëve në Kosovë. Shumë¹⁹ prej këtyre donatorëve në vitet e mëhershme i kanë angazhuar në masë të madhe fondacionet vendore të

dhënies së granteve si ndërmjetësuese për të dhënë grante nga fondet e tyre. Shumica e fondeve nga organizatat ndërkombëtare të donatorëve jepen përmes proceseve publike dhe konkurruese përmes thirrjeve publike për propozime. Një shumë e konsiderueshme e financimit për sektorin e shoqërisë civile në Kosovë gjithashtu vjen nga burimet rajonale dhe ndërkombëtare të financimit, si nga fondacionet qeveritare ashtu edhe nga ato private. Në këtë drejtim, fondacionet me seli në BE e ShBA përbëjnë pjesën më të madhe të këtij lloji të financimit.

Institucionet e Kosovës gjithashtu kanë qenë burim i rëndësishëm i financimit, sidomos për organizatat e vogla lokale. Raporti i Zyrës për Qeverisje të Mirë, i nxjerrë me mbështetje të një projekti të financuar nga Bashkimi Evropian, për herë të parë ka ofruar informacione për transfertat për OJQ-të nga burimet publike të financimit. Raporti tregon se gjatë periudhës 2014-2015 rreth 28 milionë euro u janë transferuar OJQ-ve nga njësitë e ndryshme buxhetore²⁰. Kjo shumë gjithashtu përfshin transfertat nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për shërbimet që ka

¹⁹ USAID, Komisioni Evropian, SIDA, SDC, Ministria e Jashtme e Norvegjisë, etj.

²⁰ KOHA Net. *OJQ-të për dy vjet morën 28 milionë euro nga institucionet e Kosovës*. Gjetet në: <https://www.koha.net/arberi/5662/ojq-te-per-dy-vjet-moren-28-milione-euro-nga-institucionet-e-kosoves/>

kontraktuar OShC-të²¹, grante për klube sportive, organizata kulturore, si dhe për artistë individualë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bashkëfinancime (fondet e përputhshme) të projekteve të financuara nga donatorët, si dhe forma të tjera të transfertave të parave për OJQ-tw. Publikimi i këtij raporti ishte hap fillestar për rritjen e transparencës sa i takon financimit të OJQ-ve përmes fondeve publike, dhe nevojiten hapa shtesë për të siguruar transparencë më të madhe dhe llogaridhënie sa i takon dhënies së fondeve publike.

Për ta adresuar aspektin e transparencës dhe të financimit, në qershor të vitit 2017 Ministria e Financave ka miratuar një rregullore për kushtet dhe procedurat për financim të OShC-ve²², që përfshinw proceset publike dhe konkurruese, kriteret transparente të vlerësimit, komisionet e jashtme tw vlerësimit, si dhe masat përcjellëse të monitorimit të të gjitha projekteve që marrin fonde publike. Niveli i implementimit të kësaj rregulloreje dhe efektet që ajo prodhon në terren ende nuk dihen.

Hapësira për aktivizëm është një dimension tjetër i rëndësishëm që

konsiderohet parakusht i detyrueshëm për një mjedis të përshtatshëm të OShC-ve dhe për një shoqëri civile të qëndrueshme. Në këtë aspekt, pjesa e madhe e dy viteve të fundit u karakterizua me një ngecje politike që thuhet nuk i ka lënë fare hapësirë angazhimit civil dhe avokimit. Tensionet e rritura politike dhe polarizimi i gjithëmbarshtëm për shkak të proceseve zgjedhore të shkaktuara nga temat e mëdha politike e kanë tkurrur hapësirën për aktivizëm dhe e kanë kufizuar mundësinë e shoqërisë civile të avokojë në mënyrë efektive për kauzat e saj. Sfera publike (si politika ashtu edhe mediat) ishte kryesisht e monopolizuar nga çështjet që konsideroheshin si tema të interesit kombëtar. Viti 2017 u karakterizua si vit zgjedhor gjatë të cilit u mbajtën edhe zgjedhjet e parakohshme nacionale edhe ato të rregullta lokale. Ngecja sa i përket ratifikimit të marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi²³ çoi në votën e mosbesimit të koalicionit qeverisës në maj, duke prodhuar zgjedhje të parakohshme në qershor. Në shtator u formua koalicioni i ri (i gjerë). Ky koalicion konsiderohet ndër qeverisjet më jostabile deri më sot, por brishtësia e saj dëshmohet edhe me shumicën e

21 Shërbimet sociale dhe familjare si strehimi, shërbimet bazike për kategoritë e cënueshme, etj.

22 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Stadardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14831>

23 Kusht i vendosur nga BE-ja si pjesë e kriterit politik dhe i marrëdhënieve të mira fqinjësore në procesin e liberalizimit të vizave.

thjeshtë prej vetëm një vote në Kuvend. Edhe pse zgjedhjet e rregullta lokale u mbajtën në tetor dhe nuk u shënua ndonjë problem i madh, shumë kuvende komunale nuk u formuan deri në dhjetor, për shkak të raundeve të dyta zgjedhore, rinumërimeve, dhe afateve ligjore për ankesa dhe parashtesa, deri në certifikimin formal të rezultateve nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

Në një mjedis të tillë politik, Kosova ka ngecur mbrapa procesve të parapara dhe planeve të zbatimit (zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, marrëveshje e vetme ndërmjet Kosovës dhe BE-së). Si rrjedhojë, shumë procese të mbështura/të lehtësuara nga OShC-të dhe institucionet të cilat fillimisht kishin për qëllim të zhvilloheshin krahas zbatimit të MSA-së mbetën mbrapa. Krimi i organizuar dhe korrupsioni vazhdojnë të paraqesin sfidë të madhe për Kosovën. Ende nuk ka ndjekje të suksesshme të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë politik. Deputetët e Kuvendit, ministrat e dikurshëm dhe aktualë, kryetarët e komunave, gjyqtarët dhe zyrtarët e tjerë të nivelit të lartë akuzohen për abuzim të pushtetit, mashtrim e shpërlarje të parave e megjithatë ende lejohen të marrin pjesë në jetën publike. Megjithëse OShC-të dhe rrjetet e gazetarisë hulumtuese vazhdimisht kanë raportuar për skandale korrupsioni dhe e kanë ngritur flamurin

për praktika të dyshuara korrupsioni, rezultatet në praktikë kanë qenë mjaft të kufizuara. Kjo ka ndodhë pjesërisht për shkak të mungesës së mbështetjes

lokale për punën e OShC-ve kundër korrupsionit, si dhe për shkak të mungesës së komuniteteve të forta. Arsyeja tjetër për këtë ka qenë politizimi i gjyqësorit dhe i sektorit të sundimit të ligjit, dhe institucionet e dobëta shtetërore. Ligji i ri për Sinjalizues të cilit Qeveria së fundi ia ka dërguar Kuvendit është një zhvillim i cili mund të krijojë momentum për angazhim më të madh të publikut/komuniteteve në fushën e antikorrupsionit dhe të përmirësimit të efikasitetit të përpjekjeve të shoqërisë civile.

2.11 Korniza ligjore dhe institucionale

Mjedisi ligjor i cili rregullon OShC-të vazhdon të përmirësohet dhe në vitin 2017 ka pasur një numër procesesh dhe nismash. Ligji i vitit 2011 për Lirinë e Asociimit të OJQ-ve, i cili rregullon regjistrimin dhe veprimtarinë e OShC-ve është në proces të risihikimit. Ky

Mjedisi pengues për aktivizëm ku sfera publike monopolizohet nga politika ditore dhe rivaliteti politik për t'u dhënë përparësi çështjeve të politikës së lartë.

legjislacon bazik aktualisht është mjaft i paqartë sa i përket kontraktimit publik të OJQ-ve, derisa qasja e gjithëmbarshme e implementimit të këtij ligji ka qenë kufizuese e jo mbështetëse. Duke përdorur argumente të parandalimit të keqpërdorimit, në shumë raste qasja e institucioneve ka penguar rritjen e shoqërisë civile. Ky ligj parasheh dy format organizative: 1) Shoqatë e bazuar në anëtarësi apo 2) Fondacion, që menaxhohet nga bordet e pavarura. Këto forma konsiderohet se paraqesin pengesë dhe nuk pasqyrojnë llojllojshmërinë as edhe të modeleve aktuale të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë. Duke marrë parasysh ndryshimin e Ligjit për Lirinë e Asocimit dhe me qëllim të krijimit të një mjedisi përkrahës për shoqërinë civile, ka gjithashtu hapësirë të konsiderueshme për të nxjerrë dobi të madhe nga ekspertiza e OJQ-ve sa i përket ofrimit të këshillimeve dhe shërbimeve përmes mundësisë të partneriteteve ndërsektoriale. Organizimi i komunitetit përmes OJQ-ve me 'hapësirë të përbashkët të punës', shërbimet e inkubatorit për entitetet fillestare, shërbimet e hibridet e ndryshme të ndërmarrjeve shoqërore tashmë janë të pranishme në Kosovë dhe legjislaconi i ardhshëm duhet t'i marrë parasysh këto organizime. Universitetet jopublike shpesh regjistrohen si OJQ në Kosovë. Kjo

është gjithashtu një formë e organizimit për shumë institucione mikrofinanciare, oda ekonomike, shoqata profesionale apo sektoriale, institute dhe madje edhe Agjenci Rajonale për Zhvillim, në bordet e të cilave marrin pjesë kryetarët e komunave. Të gjitha këto janë të regjistruara si OJQ në Kosovë në bazë të Ligjit për Lirinë e Asocimit. Klubet sportive, festivalet kulturore, produksionet filmike, dhe shumë forma të tjera kulture dhe argëtimi janë gjithashtu të organizuara si OJQ dhe të regjistruara si Fondacione ose si Asociacione.

Ligji i Prokurimit Publik i njëj OJQ-të si operatorë ekonomikë të kualifikueshëm për të aplikuar për të gjitha thirrjet për tenderë. Megjithatë, për të konkurruar për këto kontrata, edhe sot OJQ-të duhet të sigurojnë një varg dokumentesh, e të cilat në praktikë OJQ-të nuk detyrohen t'i posedojnë. Nëse procesi administrohet online, përmes sistemit të automatizuar, OJQ-të mund të preken në masë të

Rishikimi aktual i Ligjit për Lirinë e Asocimit dhe të ligjeve të tjera relevante duhet të përdoret për: a) Diversifikimin e formave të mundshme të regjistrimit përveç atyre aktuale; b) Definimin e qartë të beneficioneve /lirimeve të ndryshme fiskale për OshC-të.

madhe²⁴. Kështu, OJQ-të duhet të avokojnë në mënyrë efektive për t'u përfshirë në sistemin e prokurimit që të kenë dobi nga transparencja në rritje e kontraktimit publik dhe jo të preken në atë masë nga një sistem i cili parashih një nivel të tillë transparence, e i cili për shumë vjet me radhë është avokuar nga shumë OJQ.

Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve është edhe një shtojcë që rregullon mjedisin ligjor të veprimtarive të OShC-ve. Rregullorja parashih një sistem më transparent të mbështetjes financiare për OJQ-të nga institucionet e Kosovës. Rregullorja definon procesin e planifikimit dhe të dhënies së fondeve për OJQ e cila ka të bëjë me gjithë financimin publik. Disa prej kriterëve dhe procedurave janë:

- Parashikimi i mbështetjes financiare për OJQ-t në buxhetet vjetore gjegjëse të institucioneve;
- Planifikimi i llojeve dhe fushave të mbështetjes sipas buxheteve të miratuara;
- Shpallja e thirrjeve të hapura në bazë të kriterëve të qarta dhe formave standarde për aplikim,

bashkë me informacione të hollësishme për aplikim;

- Vlerësimi i aplikacioneve në bazë të një sistemi të standardizuar dhe përmes një Komisioni Vlerësues, i cili gjithashtu duhet të përfshijë ekspertë të jashtëm;
- Njoftimi i të gjitha palëve të interesuara dhe i publikut në lidhje me rezultatet e vlerësimit, organizatat përfituese, shumat e ndara, natyra e projekteve të mbështetura, etj.;
- Adresimi i ankesave të mundshme;
- Nënshkrimi i kontrateve për secilin projekt a program të mbështetur;
- Përcjellja e projekteve dhe programeve të mbështetura, si dhe mbledhja dhe analiza e raporteve gjegjëse;
- Hartimi i raporteve vjetore në lidhje me mbështetjen financiare të OJQ-ve me të dhëna të hollësishme për fushat dhe shumat e mbështetjes, përfituesit, shpërndarjen gjeografike dhe tematike, zbatimin e kriterëve dhe procedurave, etj.²⁵.

²⁴ Futja e sistemeve të automatizuara (online), zakonisht (sidomos në Kosovë) sjell ndërlikime të konsiderueshme në praktikë. Problemet teknike (vargu i numrave të regjistrimit nuk përfshin vargun e numrave të regjistrimit të OJQ-ve), apo listat e dokumenteve të kërkuara për tenderë mund të parashohin dokumente të cilat OJQ-të nuk i kanë, duke e bërë aplikimin/dorëzimin e aplikacionit të pamundur. Derisa sistemi aktual mundëson vendimin të jetë publik, sistemi automatikisht i bllokton/parandalon OJQ-të të marrin pjesë.

²⁵ Nga Rregullorja. Gjetet në: <https://gzkrks-govnet/ActDetail.aspx?ActID=14831>

2.1.2 Shpërndarja dhe mbulueshmëria gjeografike

Aktivitetet e shoqërisë civile nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në tërë Kosovën. Megjithëse databaza e organizatave të regjistruara nuk jep informacione të identifikueshme lehtë (të filtruara) sipas komunave, ka një masë të konsiderueshme njohurishw të grumbulluara nga hisedarët kyçë në lidhje me shpërndarjen e OShC-ve. Në këtë aspekt, informacionet në dispozicion nga burimet sekondare, të cilat përgjithësisht edhe janë konfirmuar në intervista me bashkëbisedues kyçë²⁶, tregojnë se shpërndarja e aktiviteteve të OShC-ve karakterizohet nga diferencimi qendër-periferi, ku afërsia me kryeqytetin apo me qendrat e tjera të mëdha përbëjnë qendrat ku gravitojnë OShC-të. Vendet më të vogla dhe më të largëta mbesin jo edhe aq të mbuluara nga aktivitetet e OShC-ve.

Dëshmitë e transmetuara gojariht/shembujt e dhënë nga bashkëbisedues kyçë tregojnë se një numër i madh prej rreth tre mijë (3,000) organizatash gravitojnë në dhe rreth kryeqytetit, Prishtinës, ku përqendrohet pjesa më e madhe e donatorëve. Aspekti tjetër i shërndarjes joproporcionale në favor të kryeqytetit

gjithashtu konsiderohet të jetë prania e institucioneve qendrore (Kuvendi, Qeveria, Gjyqësori, Agjencitë e Pavarura). Pra, kjo nënkupton se veprimtaria e konsiderueshme e OShC-ve, që ka të bëjë me përcjelljen e qeverisë qendrore dhe të degëve të saj, është fizikisht e vendosur në dhe rreth Prishtinës. Faktori i tretë i cili i kontribon kësaj shpërndarjeje të jobarabartë të organizatave është disponueshmëria e ekspertëve jashtë kryeqytetit. Kapitali njerëzor bëhet më i rrallë sa më shumë që largohemi nga kryeqyteti. Të dhënat e transmetuara gojariht tregojnë se në disa prej komunave më të vogla dhe më të largëta ka shumë pak ose nuk ka fare veprimtari të OShC-ve. Zonat më të largëta si Mamusha apo Dragashi kanë më së paku organizata të regjistruara.

Dëshmitë në praktikë (veprimtaria e dukshme e shoqërisë civile) tregojnë se pjesa e mbetur e OShC-ve aktive sillen rreth qendrave të mëdha administrative dhe rajonale të Kosovës, dhe atë në: Prizren, Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, dhe Gjakovë. Duke marrë parasysh vëshitësitë praktike për të identifikuar OShC-të në secilin komunë, nxjerrja e mostrave për anketë gjithashtu u realizua në mënyrë rajonale, duke nxjerrë në pah veprimtarinë e OShC-ve në secilin prej

²⁶Aktivitetet e shoqërisë civile me përvojë dhe njohuri, përfaqësues të organizatave vendore të dhënies së granteve, etj.

pesë rajoneve. Qasja e tillë mundëson të kuptuarit më të qartë të shpërndarjes rajonale të përgjigjeve të marra.

Në aspektin tematik, OShC-të përfshihen në aktivitete të llojllojshme siç është ofrimi i shërbimeve, politikat dhe qeverisja, shëndetësia, arsimi, infrastruktura e zhvillimi ekonomik dhe ndërmarrësia, mjedisi, të drejtat e njeriut, kultura, rinia, sporti, inovacioni, dhe shumë aktivitete e sektorë të tjerë.

Një aspekt tjetër përmes të cilit u filtrua analiza ka të bëjë me llojin e organizatës për të cilën themeluesit janë përcaktuar në momentin e regjistrimit. Në këtë drejtim, mund të zhvillohet konsistenca sa i përket raporteve apo trendeve programuese. Nga kjo perspektivë, shumica dërmese e organizatave e kanë definuar veten në momentin e regjistrimit si organizata kulturore, rinore, sportive, të grave, të të drejtave të njeriut, *think-tank*, institute apo ndonjë formë e shoqatave të bazuara në anëtarësi. Megjithëse informacionet në dispozicion nuk japin dëshmi përfundimtare të nivelit të pajtueshmërisë me misionin e vizionin parësor, apo me identitetin parësor dhe formën e organizimit, vlerësimi i

aspekteve të ndryshme të veprimtarisë së OShC-ve ka qenë i dobishëm.

2.2 Gjendja aktuale e organizatave lokale dhe me bazë në komunitetet

2.2.1 Të kuptuarit e komuniteteve në kontekstin kosovar

Definicioni i komunitetit (ang. *constituency*) sipas fjalorit Merriam-Webster jep dy kuptime të mundshme: a) një grup apo trup i cili kapitalizon, mbështetw dhe ofron përfaqësim; dhe b) njerëzit e përfshirë apo që shërbehen nga një organizatë (si bizneset apo institucionet)²⁷. Për shkak të vështirësisë së përkthimit të fjalëve "*Constituency*" apo "*Constituents*" në shqip, fjala "*komunitet*" është marrë si fjalë e vetme e cila është më e afërta për ta shpjeguar konceptin. Prandaj, fjala "*komunitet*" u përdor në këtë anketë për t'iu referuar një grupi njerëzish me të cilët punon një OJQ. Një aspekt pozitiv i kësaj mungese të përkthimit preciz të shprehjes "*constituency*" është se ndryshe nga gjuha angleze, këtu nuk paraqitet konfuzion apo keqkuptim ndërmjet

²⁷ Andrew Hacker, Available at: <https://merriam-webster.com/dictionary/constituency>

elektoratit të partive politike dhe komunitetit të OShC-ve.

Për shkak të llojllojshmërisë së madhe sa i përket llojit dhe madhësisë së organizatave të anketuara, është e vështirë të kuantifikohen informacionet e mbledhura prej tyre sa i takon të kuptuarit e tyre të komuniteteve. Por, analiza kualitative tregon se përveç një numri të vogël të organizatave siç janë odat ekonomike, shoqatat profesionale, dhe grupet avokuese të të drejtave të njeriut të cilat përfaqësojnë grupe të përcaktuara qartë, pjesa tjetër e organizatave kanë keqkuptime duke i marrë përfituesit si komunitet të tyre, pavarësisht faktit se përfituesit janë grup fluid i cili ndryshon sipas financimit të projektit dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me misionin e tyre të gjithëmbarshtëm. Po ashtu, shumë prej OShC-ve e ngushtojnë konceptin e komunitetit brenda stafit dhe anëtarëve të tyre dhe nuk kanë shumë

ide sa i përket komunitetit si tërësi apo një grupi të madh të synuar.

Kur u pyetën nëse ato kanë grupe kyçe në të cilët mbështeten dhe ndaj kujt ndjehen llogaridhënës, gati 70% e organizatave janë përgjigjur pozitivisht. Megjithatë, ajo që është interesante nga përgjigjet është shtrirja e tyre gjeografike. Organizatat nga Prishtina dhe Peja me 83% respektivisht 80% prijnë sa i takon raportimit se kanë komunitete/pjesëtarë. Organizatat e rajonit të Prizrenit janë të përfaqësuara me 15% më pak, ku 67% prej tyre raportojnë se kanë komunitete/pjesëtarë. Lidhja më e dobët me komunitetet duket të jetë në rajonin e Mitrovicës dhe në atë të Gjilanit, ku 37% respektivisht 25% raportojnë se kanë komunitete/pjesëtarë. Gjithashtu ka organizata të cilat raportojnë shkëputje të tërësishme nga komunitetet e tyre.

Përgjigjja	Rajonet					Gjithsej
	Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Pejës	Rajoni i Prizrenit	Rajoni i Mitrovicës	Rajoni i Gjilanit	
Po	83.3%	80.0%	66.7%	37.5%	25.0%	69.4%
Jo	16.7%	20.0%	33.3%	62.5%	75.0%	30.6%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Figura 2: Pjesëtarët dhe komunitetet

2.2.2 Qeverisja dhe strukturat

Qeverisja është aspekti kyç i veprimtarisë së OShC-ve dhe i qëndrueshmërisë së sektorit. Në këtë drejtim, legjislacioni ekzistues kërkon të bëhet dallim ndërmjet strukturës qeverisëse dhe menaxhmentit, gjegjësisht ndarja ndërmjet Boardit/Kuvendit të Anëtarëve dhe menaxhmentit e stafit. Legjislacioni parashih ndarje të qartë të qeverisjes ndërmjet bordit dhe menaxhmentit, por në praktikë kjo ndodh shumë rrallë. Informacionet e grumbulluara përmes anketës me OShC tregojnë se shumica e organizatave të mostrës kanë ndërmjet pesë dhe shtatë anëtarë, në 43% gjegjësisht 29% të rasteve. Rreth 24% e organizatave deklarojnë të kenë tre anëtarë të bordit, derisa 10% prej tyre kanë më shumë anëtarë. Pasqyra e plotë e rezultateve të kryqëzuara sipas rajonit sa i përket numrit të anëtarëve të bordit paraqitet në Figurën 1.

Shikuar nga aspekti historik, duket se me kohë madhësitë e bordit

zvoglohen, ku organizatat më të vjetra kanë borde më të mëdha derisa ato më të reja kufizohen me më pak anëtarë. Në lidhje me këtë, 17% e organizatave të regjistruara ndërmjet viteve 2000 – 2005, kishin tre anëtarë të bordit, 33% kishin pesë anëtarë, derisa 50% kishin disa anëtarë. Nga organizatat e periudhës 2006–2010, 11% deklaruan të kenë tre anëtarë, derisa 44% raportojnë të kenë pesë deri në shtatë anëtarë të bordit. 17% e organizatave të regjistruara në vitin 2016 dhe tutje raportojnë të kenë tre anëtarë të bordit, derisa pjesa e mbetur prej 83% është me pesë anëtarë. Sa i takon përfaqësimin gjinor, shumica e organizatave raportojnë të kenë një apo më shumë gra në përbërje të bordit, derisa gjithashtu raportojnë një shpërndarje të konsiderueshme sa i përket moshës së anëtarëve të bordit. Për sa i takon moshës së kryesuesve, 40% e organizatave raportojnë se këtë pozitë e mbajnë personat më të rinj se 35 vjeç.

Nr. i anëtarëve të bordit	Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Pejës	Rajoni i Prizrenit	Rajoni i Mitrovicës	Rajoni i Gjilanit	Gjithsej
3 anëtarë	36.8%	14.3%		12.5%	50.0%	23.8%
5 anëtarë	42.1%	42.9%	83.3%	25.0%		42.9%
7 anëtarë	10.5%	42.9%	16.7%	62.5%	50.0%	28.6%
13 anëtarë	10.5%					4.8%

Figura 3: Numri i anëtarëve të bordit sipas rajonit

Megjithëse nuk ka dëshmi nga të dhënat për sa u përket arsyeve për këtë situatë, dëshmitë e transmetuara gojarisht tregojnë se njëri prej faktorëve kryesorë për këtë mund të jetë funksionaliteti i strukturës së bordit të OShC-ve. Sipas raportit USAID CSO SI 2017 për Kosovën, "Me letra, OShC-të i kanë të definuara qartë strukturat menaxhuese, duke përfshirë edhe ndarjen e riorganizuar të përgjegjësiave ndërmjet bordit të drejtorëve dhe anëtarëve të stafit, duke qenë se kjo është kërkesë ligjore për regjistrim. Por, bordet shpesh ekzistojnë për hir të formalitetit dhe rrallëherë përfshihen në qeverisjen e organizatave"²⁸

Aspekti tjetër me të cilin u mor hartëzimi për sa u takon strukturave dhe sistemeve të qeverisjes është ekzistenca e kuvendeve të anëtarëve. Në lidhje me këtë 73% e organizatave të mostrës raportojnë të kenë këtë strukturë të qeverisjes. Nuk ekziston ndonjë dallim i madh gjeografik për sa i përket shpërndarjes së këtyre përgjigjeve brenda rajoneve, por ka disa gjetje interesante që kanë të bëjnë me këto përgjigje kur ato analizohen nga këndvështrimi i llojit të organizatave që ato përfaqësojnë. Për shembull, përqindja më e madhe e organizatave që raportojnë të kenë

kuvende të anëtarëve vjen nga organizatat *think-tank*, organizatat mjedisore (me 100% për nënmostër) dhe ato shëndetësore (80%). Megjithëse nuk ka ndonjë vijë të qartë ndarëse ndërmjet organizatave me anëtarësi dhe fondacioneve, organizatat si klube arti dhe format e tjera të organizimit (teatrot, ansamblet, etj.) raportojnë të kenë përqindjen më të ulët, ku 67% raportojnë të kenë një strukturë të këtillë. Anketa nuk ofron dëshmi për arsyet e kësaj situatë. Megjithatë, bashkëbiseduesit kyçë gjatë intervistës ndër arsyt kryesore për këtë situatë përmendin mungesën e njohurive dhe të përvojës sa i përket formës së organizimit dhe të qeverisjes së OShC-ve.




Figura 4: Qeverisja: Kuvendi i Anëtarëve sipas llojit të organizatës

²⁸ USAID CSO SI 2017 Raporti për Kosovën. Mund të sigurohet tek autori. Versioni publik do të jetë në dispozicion së shpejti në burimet zyrtare të USAID-it.

Shpeshtësia e takimeve të kuvendit ishte një tjetër aspekt të cilin e mbuloi kjo anketë. Rreth 10% e organizatave raportojnë se kuvendet e tyre takohen një herë në vit ose më pak. Gjysma e organizatave të kësaj mostre raportojnë se kuvendet e tyre takohen së paku një herë në vit derisa 40% e tyre raportojnë se kjo ndodh disa herë gjatë vitit në organizatën e tyre. Rajoni i Gjilanit shënon përqindjen më të madhe të organizatave që raportojnë disa takime në vit, me 100%. Rajoni i Prizrenit është i dyti në këtë aspekt me 80%. Rajoni i Pejës zë vendin e tretë me 45%, Prishtina me 23.5%, derisa rajoni i Mitrovicës raporton përqindjen më të ulët të takimeve të kuvendit më shumë se një herë në vit. Nëse shikohet sipas llojit të organizatave, duket se përqindja më e madhe e organizatave që raportojnë disa takime në vit janë ato humanitare me 100%; organizatat e demokracisë dhe qeverisjes, artistike, mjedisore, dhe rinore me 50%; organizatat shëndetësore me 33.3%; dhe organizatat e grave me 28.6%.

Shpeshtësia e takimeve të kuvendit




Figura 5: Shpeshtësia e takimeve të kuvendit

Madhësia e organizatave për sa i përket stafit ishte edhe një aspekt të cilin e mbuloi anketa dhe që lidhej me aspektin e qeverisjes. Një grumbull organizatash të kësaj mostre raportojnë të kenë gjithsej 3–6 anëtarë të stafit. Duke qenë se madhësia më e përhapur e bordit përbëhej po ashtu prej 3–5 anëtarëve, është e arsyeshme të konkludohet se shpejherë madhësia e bordeve të OJQ-ve është e njëjtë me atë të organizatës sa i përket stafit. Figura 4 jep një pasqyrë të rezultateve sipas rajonit, krahas numrit total në nivel nacional. Nga stafi i raportuar, rreth gjysma janë me orar të plotë.

duke e tkurrur edhe më tej madhësinë faktike të organizatave. Situata e vështruar flet për shqetësimin e parë në lidhje me cilësinë e qeverisjes dhe të llogaridhënies brenda organizatave.

Dëshmitë tregojnë se shpesh përbërja e bordit përfshin edhe ata që veprojnë si staf i paguar apo konsulentë të organizatës, apo miq/bashkëpunëtorë e menaxhmentit të organizatës. Shqetësimet lidhur me strukturat e qeverisjes së OShC-ve gjithashtu u ngritën në dy raportet e njëpasnjëshme USAID CSO SI për Kosovën²⁹, ku dukuria e disa personave që janë pjesë e shumë bordeve të organizatave, dhe potencialisht paraqesin konflikt interesi, vërehet menjëherë. Duke marrë parasysh madhësinë e vendit/rajoneve, ky aspekt problematik i qeverisjes së OShC-ve është zor të shmanget. Mirëpo, kufizimi i numrit të bordeve në të cilat mund të marrë pjesë një person i vetëm mund të jetë masë e cila potencialisht mund ta zbusë këtë fenomen. Duke qenë se Ligji për Lirinë e Asocimit është në proces të rishikimit, ky aspekt mund të përfshihet në amendamente.

Numri i stafit gjatë vitit të kaluar




Figura 6: Numri i stafit gjatë vitit të kaluar

Aftësia për të angazhuar vullnetarë dhe shfrytëzimi i tyre për arritjen e objektivave të tjera gjithashtu ishte marrë parasysh gjatë hartëzimit. Shumë raporte e analiza në Kosovë e vlerësojnë këtë aspekt si të ulët, derisa disa sosh e vënë atë në shkallë më të lartë. Indeksi i Shoqërisë Civile i KCSF-së 2016 thotë se numri i vullnetarëve të angazhuar në organizata është sa katërfishi i numrit të stafit të paguar nga organizatat³⁰. Pavarësisht këtij përfundimi, dhe duke pasur një numër të konsiderueshëm organizatash të cilat mobilizojnë me qindra vullnetarë,

²⁹ Raporti për Kosovën. USAID CSO SI 2013 – 2016.

³⁰ KCSF Index 2016. Page: 53.

përkundër një numri të vogël stafi të paguar, të gjitha burimet relevante e vlerësojnë nivelin e vullnetarizmit si të ulët në Kosovë. Një studim i Vullnetarizmit Rinor në Kosovë³¹, tregon se përkundër rasteve të rralla kur vullnetarët kalojnë në punë me pagesë, rreth gjysma e të gjithë të anketuarve (49%) kanë identifikuar fitimin e përvojës dhe të shkathtësive si përfitimin primar nga vullnetarizmi, derisa në vendin e dytë vjen kontributi për zhvillimin e bashkësisë (18%). Ky raport gjithashtu identifikon mungesën e gjithëmbarshme të ofertave apo mundësive për të bërë punë vullnetare si dhe angazhimin në shkollë si arsyt kryesore për shkallën e ulët të pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitetet vullnetare. Raporti USAID CSO SI për vitin 2017, duke cituar Indeksin Botëror të Donacioneve për vitin 2017, thotë se vetëm 6% e kosovarëve kanë marrë pjesë në aktivitete vullnetare, që sipas raportit përbën rënie kundrejt viteve të kaluara³². Tabela 7 në vijim jep një pasqyrë vizuale të angazhimit vullnetar sipas llojit të organizatave. Siç mund të shihet, më shumë se 65% e organizatave (kolona e totalit) raportojnë të kenë pesë apo më pak vullnetarë në vitin 2018. Kjo situatë konfirmon supozimet e niveleve të

vullnetarizmit në Kosovë dhe shtron pyetje për mënyrat e përmirësimit.

³¹ Të Rinjtë dhe Vullnetarizmi në Kosovë: Mundësia për të Mësuar –Studim nga UNDP / UNV në Kosovë, i zhvilluar nga KPPC. Gjetet në: <http://www.kppcenter.org/volunteerism.html>

³² USAID CSO SI 2017 për Kosovën.

2018 total	Lloji i organizatës								Total
	OJQ Rinore	OJQ e grave	Think Tank	Demokraci dhe Qeverisje	Humanitare /Bamirëse	Mjedisore	Shëndetësore	Artistike	
0 vullnetarë	16.7%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	3.4%
1 vullnetar	0.0%	20.0%	0.0%	66.7%	0.0%	25.0%	0.0%	0.0%	13.8%
2 vullnetarë	0.0%	40.0%	100.0%	0.0%	0.0%	0.0%	25.0%	50.0%	17.2%
3 vullnetarë	16.7%	40.0%	0.0%	0.0%	0.0%	25.0%	25.0%	0.0%	17.2%
4 vullnetarë	0.0%	0.0%	0.0%	33.3%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	3.4%
5 vullnetarë	16.7%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	25.0%	25.0%	0.0%	10.3%
8 vullnetarë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	25.0%	0.0%	0.0%	0.0%	3.4%
11 vullnetarë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	25.0%	0.0%	0.0%	0.0%	3.4%
20 vullnetarë	16.7%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	25.0%	0.0%	0.0%	6.9%
21 vullnetarë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	25.0%	50.0%	6.9%
22 vullnetarë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	25.0%	0.0%	0.0%	0.0%	3.4%
34 vullnetarë	33.3%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	6.9%
170 vullnetarë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	25.0%	0.0%	0.0%	0.0%	3.4%
Gjithsei	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Figura 7: Numri i vullnetarëve të angazhuar në vitin 2018

2.2.3 Fokusi aktual i programeve

Një dimension tjetër i prekur nga ky hartëzim kishte të bënte me format më të shpeshta të aktiviteteve në të cilat përfshihen organizatat lokale dhe ato me bazë në komunitetet. Tri llojet më

të raportuara të aktiviteteve në të cilat përfshihen OShC-të janë avokimi dhe lobimi, barazia gjinore, dhe edukimi/trajnimi. Në rajonin e Prishtinës, që gjithashtu përbën masën e konsiderueshme të veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile, 52% prej tyre raportojnë angazhimin në avokim dhe lobim. Edukimi/trajnimi në rajonin e Prishtinës raportohet nga

45% e organizatave të mostrës, derisa barazia gjinore raportohet të jetë në fokus të 28% të organizatave. Barazia gjinore përbën angazhimin më të spikatur në rajonin e Pejës dhe atë të Prizrenit me 36% respektivisht 29% të organizatave, derisa asnjë organizatë në rajonin e Gjilanit nuk raporton aktivitetet të këtyllë. Mitrovica gjithashtu ka përqindje të vogël aktiviteteve në fushën e barazisë gjinore, me vetëm 7% të organizatave me këtë lloj aktiviteti nga ky rajon. Brenda vetë rajonit, barazia gjinore zë vendin e dytë në listën e aktiviteteve. Edukimi/trajnimi përbën aktivitetin më të shpeshtë në rajonin e Mitrovicës, ku 18% e organizatave raportojnë se merren me aktivitete të kësaj fushe. Kjo veprimtari gjithashtu përbën njërin prej dy aktiviteteve në rajonin e Gjilanit. Aktivitetet kulturore/rinore/sportive janë gjithashtu pjesë e aktiviteteve të raportuara. Rajoni i Prishtinës gjithashtu dominon sa i përket këtij lloji të aktivitetit, dhe ndiqet nga Peja dhe Prizreni, të cilat gjithashtu raportojnë aktivitete të konsiderueshme të kësaj fushe. Edhe Mitrovica raporton aktivitete në këtë fushë, derisa organizatat e rajonit të Gjilanit nuk kanë raportuar ndonjë aktivitet të këtyllë. Figura 7 jep një pasqyrë të veprimtarisë së OShC-ve sipas rajonit. Ky ilustrim nuk përfshin edhe përgjigjet e tjera, të cilat në shumicën e rajoneve

nuk janë raportuar. Aktivitetet e tilla përfshijnë vullnetarizmin, shëndetësinë, punësimin, ndërmarrjet shoqërore, mbështetjen për personat me nevoja të veçanta, trashëgiminë kulturore, dhe ato kryesisht janë raportuar nga një deri në dy organizata brenda një rajoni.

Fokusi i programeve aktuale




Figura 8: Fokusi aktual i programeve sipas rajonit

Anëtarësia në rrjete vendore e ndërkombëtare është aspekti tjetër të cilin e mbulon ky hartëzim. Më shumë se 60% e organizatave të mostrës raportojnë se nuk janë anëtare të ndonjë rrjeti ndërkombëtar a vendor. Mungesa e pjesëmarrjes në rrjete është një faktor tjetër që pengon suksesin e organizatave të shoqërisë

civile për të avokuar për të drejtat e tyre. Mungesa e koalicioneve të ndërtuara rreth çështjeve të caktuara, mungesa e organizatave dhe rrjeteve ombrellë dhe jofunksionaliteti apo jofunksionaliteti i pjesëshëm i atyre ekzistuese pengojnë përpjekjet bashkërenduese dhe avokuese dhe kufizojnë rezultate në praktikë. Ato shkaktojnë copëzim të veprimtarisë së shoqërisë civile dhe, përderisa në rrjete ndërkombëtare arsytet për mungesë anëtarësimi mund të kenë lidhje me aspekte financiare dhe të përballueshmërisë, anëtarësia në rrjete vendore zakonisht nuk kushton aq shumë. Faktori tjetër që ndikon në mosanëtarësim në rrjete ndërkombëtare ka të bëjë me vështirësitë e udhëtimit dhe të pjesëmarrjes në aktivitetet e rrjetit. Kufizimet e udhëtimit për kosovarët e bëjnë më të vështirë edhe pjesëmarrjen profesionale të organizatave nëpër rrjete, sidomos kur kemi parasysh se ato zakonisht nuk janë në gjendje të marrin pjesë në shtetet të cilat nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Rezultatet e analizës sipas llojit të organizatës janë shumë domethënëse. Organizatat me rrjetëzime më të shtrira duken të jenë OShC-të e grave, OShC-të e demokracisë dhe qeverisjes dhe organizatat e artit, të cilat raportojnë përqindje më të mëdha të anëtarësimit në rrjete me 80%, 60%

gjegjësisht 43%. Organizatat rinore duken të jenë më pak të përfaqësuara në rrjete, me vetëm 29% prej tyre anëtare të rrjeteve vendore apo ndërkombëtare. Lloji i vetëm i organizatës me më pak rrjetëzime janë organizatat *think-tank*, prej të cilave vetëm 20% raportojnë të jenë anëtare të rrjeteve.

Anëtarësia në rrjete vendore apo ndërkombëtare sipas llojit të organizatës




Figura 9: Anëtarësia në rrjete vendore apo ndërkombëtare sipas llojit të organizatës

Qëndrueshmëria financiare dhe institucionale

Diversifikimi i burimeve të financimit është njëra prej vështirësive kryesore të qëndrueshmërisë me të cilat ballafaqohen OShC-të. Në lidhje me

këtë, aspektet e tjera të qëndrueshmërisë përfshijnë mbajtjen e stafit dhe zhvillimin e tyre si dhe paqartësitë e tjera në afat të gjatë e të cilat varen nga disponueshmëria e burimeve financiare. Ky dimension i qëndrueshmërisë së OShC-ve gjithashtu është identifikuar/evidentuar si një ndër më problematikët për t'u arritur. Dy raportet e njëpasnjëshme USAID CSO SI vlerësojnë qëndrueshmërinë financiare si një ndër dimensionet më të dobëta në të cilat fokusohet Indeksi. Raporti i vitit 2017 vendos qëndrueshmërinë financiare në pikën 4.5 në një shkallë 7-pikëshe³³, ku indeksi vendor i qëndrueshmërisë është 3.7. Një rangim i tillë e radhitw qëndrueshmërinë financiare për 0.8 pikë nën mesataren e indikatorëve vendorë të qëndrueshmërisë në një shkallë 7-pikëshe.

Në rajonin e Prishtinës, fondacionet vendore (60%), dhe institucionet qendrore (44%) përbëjnë dy prej burimeve më të raportuara të financimit. Organizatat ndërkombëtare raportohet të jenë burim i të hyrave për 38% të organizatave në këtë rajon. Komuna është burimi më së paku i raportuar i financimit në rajonin e Prishtinës, me vetëm 18% të organizatave që e kanë raportuar këtë burim. Në rajonin e Pejës vërehet

diversifikimi i ngjashëm i burimeve, ku fondacionet vendore përbëjnë burimin e financimit për pjesën më të madhe të organizatave (40%). Organizatat ndërkombëtare janë raportuar si burim i financimit nga 28% e organizatave në rajonin e Pejës derisa 18% prej tyre i kanë përmendur institucionet qendrore si burime të financimit. Komuna gjithashtu zë vendin e katërt në rajonin e Pejës me vetëm 12% të organizatave që e përmendin atë si burim të financimit. Në rajonin e Mitrovicës, Prizrenit dhe Gjilanit situata është pak më ndryshe. Në këto zona, burimi primar (më i raportuar) i financimit janë komunat me 18%, 41% gjegjësisht 12%. Institucionet qendrore janë burimi i dytë i financimit në këto tri rajone me 19%, 13% dhe 6% të organizatave në rajonet gjegjëse. Organizatat ndërkombëtare zënë vendin e tretë sa i përket burimit të financimit në rajonin e Mitrovicës, Gjilanit dhe Prizrenit, derisa fondacionet lokale nuk raportohen si burime.

³³ CSO SI përdor shkallën 1-7 ku 1 përbën nivelin më të lartë të qëndrueshmërisë, derisa 7 paraqet nivelin më të ulët.

Burimet aktuale të financimit




Figura 10: Burimet aktuale të financimit

Vlera aktuale e projekteve në portofol ishte gjithashtu pjesë e kësaj ankete me OShC-të. Në këtë aspekt, vetëm 13% e tyre raportojnë portofol aktiv me më shumë se 100,000 euro. Nga 50,000 deri në 100,000 euro është portofoli aktiv i 10% të organizatave. Ndërmjet 20,000 dhe 30,000 eurove është portofoli aktual i projekteve të 13% të organizatave në mostër. 16% e organizatave raportojnë portofol aktual të projekteve me vlerë ndërmjet 10,000 dhe 20,000 euro. Përqindja më e madhe e organizatave në këtë mostër (28%) raporton buxhete vjetore ndërmjet 5,000 dhe 10,000 euro, derisa

16% e organizatave raportojnë portofol prej më pak se 5,000 euro.

Kur bëhet analiza sipas llojit të organizatave, ato që identifikohen si organizata të artit dhe ato mjedisore duket se përbëjnë përqindjen më të madhe me portofol mbi 100,000 euro, ku hyjnë 33% gjegjësisht 17% e organizatave brenda kësaj nënmostre. 50% e organizatave të demokracisë dhe qeverisjes, 33% e organizatave bamirëse/humanitare, dhe 17% e organizatave mjedisore të kësaj mostre raportojnë portofol aktiv ndërmjet 50,000 dhe 100,000 euro. Figura 10 jep pasqyrën e plotë të përgjigjeve të ndara në kategori/lloje të organizatave.

Portfolio aktual i projekteve




Figura 11: Vlera aktuale e portfolios së projekteve aktuale sipas llojit të organizatës

Përveç vlerës së portofolëve aktualë, hartëzimi gjithashtu ka përfshirë numrin e projekteve aktuale aktive që zbatohet nga organizatat e anketuara. Në këtë aspekt, numri më i madh i organizatave brenda secilit rajon raportojnë të kenë vetëm një projekt aktiv (41% e organizatave të mostrës). Përqindja e organizatave që raportojnë dy projekte aktive është 28% derisa 15% e organizatave të mostrës raportojnë tri projekte aktive. Pjesa e mbetur sa i përket numrit të projekteve në zbatim e sipër përbën më pak se 10% të organizatave të anketuara.

Nëse shikohet nga aspekti i rajoneve, duket se rajoni i Mitrovicës përbën përqindjen më të madhe të organizatave të cilat raportojnë vetëm një projekt aktiv, me 71% të organizatave që raportojnë një situatë të tillë. Rajoni i Prizrenit është i dyti me radhë sa i përket përqindjes së organizatave me vetëm një projekt aktiv (57% e organizatave nga ky rajon). Gjilani dhe Peja paraqiten me 33% të organizatave brenda rajonit gjegjësisht me vetëm një projekt aktiv, derisa rajoni i Prishtinës raporton përqindjen më të ulët të organizatave me vetëm një projekt aktiv, ku hyjnë 30% e organizatave. 28% e organizatave nga rajoni i Prizrenit raportojnë më shumë se gjashtë projekte aktive në zbatim e sipër. Asnjë

organizatë në rajonet e tjera nuk ka raportuar gjashtë projekte aktive. Figura 11 jep një pasqyrë të përgjigjeve të marra dhe të ndara sipas rajonit.

Numri i projekteve aktive




Figura 12: Numri i projekteve aktive sipas rajonit

2.2.4 Përpjekjet avokuese dhe aktivizmi me bazë në komunitet

Një dimension tjetër i anketës së hartëzimit mbulon përpjekjet aktuale avokuese dhe nivelin e aktivizmit me bazë në komunitet. Komponenti më i rëndësishëm në këtë aspekt është procesi i grumbullimit të informacioneve nga komuniteti me

qëllim të identifikimit të nevojave avokuese. Kur u pyetën nëse i përfshijnë nevojat e komuniteteve të tyre kur hartojnë projekte, 94,22% e organizatave pohuan se e bënin një gjë të tillë. Mënyra më e shfrytëzuar për këtë qëllim ishte komunikimi direkt gjatë takimeve direkte me komunitetin, ku 51,6% e organizatave të anketuara e përdorin këtë metodë, derisa në vendin e dytë vjen metoda e komunikimit me e-mail, që përdoret nga 16,8% e organizatave të anketuara, dhe mediat sociale nga 8,1% prej tyre. Vetëm një përqindje e vogël e këtyre organizatave (2,9%) përdorin metoda hulumtuese, si grupe të fokusit dhe anketa për këto qëllime. Megjithatë, në të shumtën e rasteve organizatat nuk ishin në gjendje të bënin dallimin ndërmjet komunitetit dhe anëtarëve të tyre, andaj takimet me komunitetin dhe takimet me anëtarët e tyre në shumicën e rasteve nënkuptonin të njëjtën gjë.

Kanalet e komunikimit	Përqindja e organizatave
Mediat sociale	8.1%
e-mail	16.8%
Takimet direkte	55.2%
Telefonatat	7.2%
Anketat dhe grupet e fokusit	2.9%
Të tjera	9.8%
Gjithsej	100.0%

Figura 13: Mënyrat e komunikimit të përdorura nga organizatat për qëllime të identifikimit të nevojave të komunitetit

Një përqindje relativisht e lartë e organizatave (31.5%) nuk kanë dhënë informacione të vlefshme sa u takon mënyrave përmes të cilave ato e përfshijnë komunitetin në implementimin e projekteve të tyre dhe në përpjekjet avokuese. Sidoqoftë, në 24.57% të rasteve pjesëtarët e komunitetit janë fillimisht të angazhuar në këto projekte në rolin e pjesëmarrësve në takime publike, debate, konferenca, etj., 17.34% e tyre angazhohen si pjesëmarrës në trajnime, seminare dhe punëtori, derisa 6.36% përfshihen si marrës të shërbimeve. Nivelet e përfshirjes në fazat e planifikimit të projektit janë shumë më të ulëta, me vetëm 5.2%. Në këtë aspekt, dështimi i përfshirjes së komuniteteve në planifikim gjithashtu prodhon mundësi të kufizuara për t'i

mobilizuar për implementim dhe pastaj edhe për ruajtjen e rezultateve.

Format e përfshirjes	% e organizatave
Pjesëmarrës në takime, debate, konferenca	24.57%
Pjesëmarrës në punëtori, trajnime, seminare	17.34%
Marrës të shërbimeve	6.36%
Ofrues të shërbimeve	1.16%
Punë vullnetare	4.62%
Planifikim i projektit	2.89%
Të anketuar	1.45%
Organizim i projektit	2.31%
Tjetër	7.80%
Nuk ka përgjigje	31.50%
Gjithsej	100.00%

Figura 14: Format e përfshirjes së komuniteteve në implementimin e projektit

Kur flasim për kërkim të llogaridhënies së organizatave nga komunitetet e tyre, 89.5% deklarojnë se ato e informojnë komunitetin në lidhje me rezultatet dhe arritjet e projekteve të tyre. Mënyrat kryesore të përdorura nga këto organizata për t'i informuar komunitetet e tyre në lidhje me rezultatet e projektit janë takimet direkte (35.26%), mediat sociale (12.43%), komunikimi përmes e-mailit (8.67%), dhe publikimet e raporteve të zbatimit të projektit (7.23%). Pjesa tjetër e organizatave, apo 16%, përdorin

telefonatat, njoftime në media nacionale e lokale, postime në uebfaqe dhe fletushka për këtë qëllim

Kanalet e komunikimit	% e organizatave
Mediat sociale	12.43%
e-mail	8.67%
Takimet direkte	35.26%
Telefonatat	1.16%
Publikimi i raporteve	7.23%
Nuk ka përgjigje	13.87%
Tw tjera	21.39%
Gjithsej	100.00%

Figura 15: Komunikimi lidhur me rezultatet dhe arritjet e projektit

Partneriteti me organizatat e tjera është aspekti i dytë i këtij dimensionit dhe 72% e të gjitha organizatave të mostrës raportojnë partneritete me organizatat e tjera. Shikuar nga aspekti rajonal, OShC-të nga Prizreni raportojnë përqindjen më të lartë të partneriteteve me 85% të organizatave nga ky rajon. Rajoni i Prishtinës është i dyti me radhë sa i përket partneriteteve të organizatave (75%), pas të cilit vjen rajoni i Pejës me 73% të organizatave që raportojnë partneritete. Organizatat e rajonit të Gjilanit shënojnë përqindjen më të ulët të partneriteteve (vetëm 33%), derisa 63% e organizatave në rajonin e Mitrovicës raportojnë partneritete.

Natyrë e partneriteteve gjithashtu dallon sipas organizatave. Derisa shumica prej tyre raportojnë aplikime për fonde si bazën primare të partneritetit, raportohen edhe format e tjera të partneriteteve. Figura 12 jep një pasqyrë të përgjigjeve në nivel të popullsisë së përgjithshme si dhe të ndarë sipas rajonit.

Partneritetet me organizatat e tjera




Figura 16: Partneritetet me organizatat e tjera sipas rajonit

Mjetet e përdorura për të avokuar për kauza, dhe aktivizmi me bazë në komunitet janë format më direkte të vlerësuara përmes këtij hartëzimi. Në këtë aspekt, organizatat u pyetën se sa shpesh takohen me përfaqësues komunalë (si ekzekutivë ashtu edhe

legjislativë), sa shpesh parashtrojnë pyetje publike, sa shpesh marrin pjesë në dëgjime publike, peticione e të ngjashme. Sa i përket kanalit të parë të avokimit dhe komunikimit – pra, takimet direkte me përfaqësues komunalë, përqindja më e madhe e organizatave (gjithsej 35%) raportojnë takime me zyrtarë komunalë disa herë në vit, 26% e organizatave të kësaj mostre raportojnë takime me zyrtarë komunalë disa herë në muaj, derisa 20% e organizatave raportojnë takime me zyrtarë komunalë një herë në vit. Vetëm 10% e organizatave raportojnë të mos jenë takuar asnjëherë me autoritetet komunale si pjesë e përpjekjeve të tyre avokuese.

Sa shpesh takoheni me përfaqësuesit e komunës / këshilltarët e kuvendit komunal?




Figura 17: Takime me përfaqësues komunalë sipas llojit të organizatës

Përmasa dhe fushëveprimi i aktiviteteve të monitorimit në nivel lokal gjithashtu janë vlerësuar në kuadër të kësaj ankete me OShC. Në këtë aspekt, 48% e organizatave të kësaj mostre raportojnë se asnjëherë nuk e monitorojnë punën e autoriteteve komunale. 18% prej tyre raportojnë monitorim të komunës një herë në vit, derisa 12% raportojnë se e monitorojnë komunën disa herë në vit. Përqindja e organizatave të cilat raportojnë monitorim të rregullt të autoriteteve komunale ishte 22% (14% me disa monitorime në muaj, dhe 8% me një monitorim në muaj). Megjithëse nuk dihen arsyet që i shtyjnë OShC-të të mos preferojnë/angazhohen në aktivitetet e monitorimit, disponueshmëria e granteve për qëllime të tilla ka qenë e madhe viteve të fundit. Interesimi i kufizuar i organizatave për t'u angazhuar në aktivitete të tilla bashkë me kapacitetet e kufizuara për të marrë fonde për projektet e tyre konsiderohen të jenë ndër arsyet parësore për përqindjet jo edhe aq të larta të organizatave që angazhohen në monitorimin e autoriteteve komunale gjegjëse.

Shikuar nga aspekti gjeografik, rajoni i Mitrovicës paraqitet të jetë me përqindjen më të lartë të organizatave që raportojnë të mos kenë përcjellë/monitoruar autoritetet lokale

(63%) pasuar nga rajoni i Prizrenit me 50% të organizatave që raportojnë të njëjtën gjë. Gjithsej 49% e organizatave nga rajoni i Prishtinës raportojnë se asnjëherë nuk e kanë monitoruar punën e qeverisë lokale derisa në rajonin e Pejës këtë e raportojnë 44% e organizatave. Në anën tjetër, organizatat më aktive sa i përket monitorimit të komunës (disa herë në muaj) gjithashtu vijnë me përqindjen më të madhe nga rajoni i Gjilanit dhe Prizrenit me nga 33%. Shpeshhtësia e monitorimit raportohet nga 22% e organizatave nga rajoni i Pejës ndërsa 8% prej tyre vijnë nga rajoni i Prishtinës.

Monitorimi i punës së komunave sipas rajonit




Figura 18: Monitorimi i komunave sipas rajonit

Dërgimi i letrave publike/pyetjeve komunës është një mjet/kanal tjetër avokues i cili u mbulua në anketë me organizatat e shoqërisë civile për qëllime të këtij hartëzimi. Në këtë drejtim, 31% e organizatave të kësaj mostre raportojnë se asnjëherë nuk u kanë dërguar institucioneve letër publike apo pyetje. Përqindje e njëjtë e organizatave (20%) kanë raportuar t'u kenë dërguar letra institucioneve një herë në vit, gjegjësisht disa herë në vit. 18% dhe 10% e organizatave raportojnë se u shkruajnë letra institucioneve 'një herë në muaj' gjegjësisht 'disa herë në muaj'.

Për sa i takon shtrirjes gjeografike të përgjigjeve, janë disa aspekte të cilat duhen përmendur sa i përket dërgimit të letrës si kanal për avokimin e çështjeve dhe të kauzave. Rajoni i Mitrovicës duket më i polarizuar sa i përket shpërndarjes së përgjigjeve ku 50% e organizatave të anketuara raportojnë se dërgojnë letra një herë në muaj, derisa gjysma tjetër, 50% e organizatave, raportojnë se nuk e përdorin këtë qasje. Në rajonin e Gjilanit, përqindja e njëjtë e organizatave (33%) raportojnë se asnjëherë nuk kanë dërguar letër, kanë dërguar letër një herë në vit, gjegjësisht dërgojnë letra një herë në muaj. Rajoni i Prizrenit shënon përqindjen më të lartë të organizatave që dërgojnë letra disa herë në muaj dhe një herë në muaj, me nga 33% të organizatave nga ky rajon. Rajoni i Pejës dhe ai i Prishtinës kanë shtrirje më të llojllojshme të përgjigjeve dhe shpërndarje më të ngjashme të përgjigjeve ndër opsionet për përgjigje.

Sa shpesh dërgoni letra/pyetje publike




Figura 19: Dërgimi i letrave apo pyetjeve publike sipas rajonit

Dëgjimet publike janë kanal tjetër avokues për të cilin janë anketuar organizatat sa i përket shpeshësisë së përdorimit të tyre. Në këtë aspekt, pjesëmarrja në takimet e tilla është mjaft e llojllojshme. Derisa disa OJQ raportojnë se marrin pjesë në dëgjime publike disa herë në muaj, gjithashtu është një përqindje e konsiderueshme e atyre që raportojnë se asnjëherë nuk shkojnë në takimet e tilla. Tabela në vijim pasqyron rezultatet sipas llojit të organizatës.

Sa shpesh merrni pjesë në dëgjime publike




Figura 20: Pjesëmarrja në dëgjime publike sipas llojit të organizatës

Një situatë e ngjashme mund të vërehet edhe sa u përket peticioneve. 41% e organizatave të anketuara raportojnë se asnjëherë nuk aplikojnë peticione në veprimtarinë e tyre për qëllime avokuese. Mesatarisht, 20% e organizatave raportojnë aplikimin e peticioneve një herë në vit. Rreth 35% e organizatave deklarojnë se organizojnë peticione disa herë në vit, derisa 4% e organizatave pohojnë se organizojnë peticione disa herë në muaj.

Reagueshmëria/koha e reagimit ndaj kërkesave tuaja




Figura 21: Kënaqësia me përgjigjet ndaj kërkesave sipas rajonit

Një aspekt tjetër në të cilin u fokusua anketa për të marrë informacione është përgjigjja e autoriteteve lokale ndaj kërkesave të organizatave të shoqërisë civile. Në këtë aspekt, shumë të kënaqura me përgjigjet e autoriteteve lokale ishin rreth 6% e organizatave, derisa më të kënaqura se të pakënaqura ishin 28% e organizatave të kësaj mostre. 32% e organizatave raportuan se nuk ishin as të kënaqura as të pakënaqura në këtë aspekt. Më të pakënaqura se të kënaqura ishin 20% e organizatave të anketuara, derisa 14% ishin shumë të

pakënaqura. Nëse përgjigjet pozitive grupohen në njërën anë dhe krahasohen me ato që shprehin ndjenjë negative lidhur me përgjigjet e autoriteteve lokale, shihet se përqindja e organizatave të cilat janë shumë të pakënaqura dhe më të pakënaqura se të kënaqura është 34%, e që është identike me përqindjen e organizatave të cilat kanë dhënë përgjigjen se janë shumë të kënaqura dhe më të kënaqura se të pakënaqura. Figura 17 paraqet një pasqyrë vizuale të rezultateve sa i përket përgjigjeve të autoriteteve lokale sipas rajonit. Siç mund të shihet nga kjo figurë, rajoni i Pejës (27%) dhe rajoni i Prishtinës (17%) janë dy rajonet e vetme me përgjigjen 'shumë të pakënaqura', derisa në tri rajonet e tjera nuk u regjistrua një përgjigje e tillë. Organizatat nga rajoni i Gjilanit në masë të madhe raportojnë të jenë më të kënaqura se të pakënaqura (67%), derisa përqindja e mbetur e organizatave (33%) raportojnë se janë neutralë ndaj përgjigjeve të autoriteteve lokale. Në rajonin e Prizrenit 43% e organizatave kanë përzgjedhur përgjigjen neutrale ndaj përgjigjeve të autoriteteve lokale, dhe më të pakënaqura se të kënaqura. Vetëm 14% e organizatave në Prizren

raportojnë të jenë më të kënaqura se të pakënaqura.

Aspekti i tjetër i anketës ishte transparenca. Në këtë drejtim, 13% e organizatave raportojnë se janë shumë të pakënaqura me nivelin e transparencës së autoriteve lokale. 30% e organizatave janë më të pakënaqura se të kënaqura, dhe e njëjta përqindje e organizatave (30%) raportojnë se janë neutralë në këtë aspekt. Më të kënaqura se të pakënaqura me transparencën e autoriteteve lokale janë shprehur 24% e organizatave të anketura, derisa shumë të kënaqura me transparencën kanë dalë 2% e organizatave. Nëse shikohet aspekti i shtrirjes gjeografike, rajoni i Pejës i prin listës së organizatave shumë të pakënaqura, me 25% nga ky rajon që zgjodhi këtë përgjigje. Rajoni i Prishtinës dhe ai i Prizrenit gjithashtu shënuan përqindje të konsiderueshme të organizatave të cilat janë shumë të pakënaqura, ku në dy rajone u shënuan totali prej 15%. Asnjëra prej organizatave në rajonin e Mitrovicës dhe të Gjilanit nuk ka raportuar pakënaqësi të madhe me transparencën e institucioneve lokale. Nëse merret grupi i dytë i përgjigjeve, tek ato që anojnë më shumë nga pakënaqësia se kënaqësia prin Prishtina me 40% të organizatave që

raportojnë se janë më të pakënaqura se të kënaqura me transparencën e institucioneve. Rajoni i Gjilanit raportohet të jetë më transparent ku një përqindje befasuese e organizatave (67%) raportojnë të jenë më të kënaqura se të pakënaqura, derisa pjesa e mbetur e organizatave raportojnë të jenë neutralë. Asnjë përgjigje që ka të bëjë me pakënaqësinë sa i takon transparencës së institucioneve lokale nuk u mor në rajonin e Gjilanit. Figura 18 pasqyron të dhëna të hollësishme lidhur me përgjigjet sipas rajonit.

Kënaqshmëria ndaj transparencës




Figura 22: Kënaqësia me transparencën sipas rajonit

Duke qenë se komunat gjithashtu përfaqësojnë burim të rëndësishëm financimi, sidomos për OShC-të e vogla që janë aktive vetëm në zonat e kufizuara gjeografike, kënaqësia me mbështetjen e marrë nga autoritetet lokale ishte po ashtu njëri prej aspekteve të kësaj ankete. Sa i përket këtij aspekti, organizatat e përfshira në këtë anketë kishin më shumë prirje drejt pakënaqësisë sesa kënaqësisë sa i përket nivelit të financimit nga komunat. 37% e organizatave raportojnë se janë më të pakënaqura se të kënaqura në këtë aspekt. Rreth

20% e organizatave të kësaj mostre raportojnë të jenë shumë të pakënaqura me nivelin e financimit nga autoritetet komunale, derisa 40% shprehen më të pakënaqura se të kënaqura dhe 30% prej tyre shprehen neutrale në këtë aspekt. Rreth 5% e organizatave në këtë mostër shprehen shumë të kënaqura me mbështetjen financiare nga komunat, derisa 12% raportojnë se janë më të kënaqura se të pakënaqura. Nëse shikohet lloji i organizatave, organizatat bamirëse/humanitare raportojnë pakënaqësinë më të madhe, ku të gjitha organizatat që e kategorizojnë veten si të tilla raportojnë të jenë shumë të pakënaqura me nivelin e financimit nga komunat. Organizatat e shëndetësisë, demokracisë dhe qeverisjes, si dhe organizatat e grave vijjnë pas tyre për sa i takon nivelit të pakënaqësisë, me 50%, 25% gjegjësisht 20% e organizatave që raportojnë të jenë shumë të pakënaqura nga secili grup gjegjës. Në anën tjetër, organizatat më të kënaqura duken të jenë ato mjedisore dhe rinore, me 18% gjegjësisht 14% prej tyre që shprehen të jenë shumë të kënaqura. Figura 19 jep një pasqyrë të përgjigjeve sipas llojit të organizatave.

Kënaqshmëria për përkrahjen financiare nga komuna




Figura 23: Kënaqësia me mbështetjen financiare sipas komunës apo rajonit

2.3 Planet për të ardhmen

Duke marrë parasysh faktin se qëllimi parësor i hartëzimit është të përkrahë mbështetjen e planifikuar për organizatat e synuara, anketa me organizata gjithashtu ka përfshirë këndvështrimin largpamës paralelisht me dokumentimin e situatës aktuale dhe të përvojave të organizatave. Në këtë aspekt, planet e strukturuar/të shkruara paraqiten te 47% e organizatave derisa 53% prej tyre raportojnë se nuk kanë plane të tilla.

Organizatave të rajonit të Mitrovicës dhe të Gjilanit duken të jenë më së paku të përgatitura për të ardhmen, ku 13% gjegjësisht 25% e organizatave deklarojnë se nuk kanë plane strategjike. 57% e organizatave në rajonin e Prishtinës dhe të Prizrenit konfirmojnë se kanë plane strategjike, derisa përqindja e organizatave me plane të tilla nga rajoni i Pejës është 56%. Nuk ka informata/dëshmi lidhur me diskrepancën ndërmjet rajoneve, por organizatat nga rajoni i Mitrovicës dhe i Gjilanit kanë nevojë për mbështetje të veçantë në aspektin e planifikimit strategjik. Mungesa e planit dhe vizionit strategjik i pengon organizatat të zhvillojnë e të zbatojnë me efikasitet projekte dhe aktivitete, duke prodhuar kështu vendimarrje ad-hoc dhe improvizime. Figura 20 jep një pasqyrë të rezultateve nga organizatat, të paraqitura vizualisht. Duhet theksuar se prej atyre që raportojnë se kanë plane strategjike, 18% raportojnë se shtrirja kohore e atyre planeve është deri në fund të vitit 2018, derisa 23% e planeve mbulojnë edhe vitin 2019. Kjo e dhënë tregon se ka nevojë të madhe për mbështetje për planifikim strategjik të organizatave të synuara.

A ka organizata juaj Plan Strategjik?		Rajonet					Gjithsej
		Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Pejës	Rajoni i Prizrenit	Rajoni i Mitrovicës	Rajoni i Gjilanit	
	Po	57.1%	55.6%	57.1%	12.5%	25.0%	46.9%
	Jo	42.9%	44.4%	42.9%	87.5%	75.0%	53.1%
Gjithsej		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Figura 24: Posedimi i Planit Strategjik sipas rajonit

Posedimi i Planeve të Qëndrueshmërisë gjithashtu ishte njëri prej aspekteve të kësaj ankete me organizatat. Në këtë drejtim, vetëm 18% e organizatave kanë dhënë përgjigje pozitive, derisa shumica dërmuese e organizatave i janë përgjigjur negativisht pyetjes në lidhje me planet e qëndrueshmërisë. Shikuar nga aspekti rajonal, rajoni i Pejës raporton nivel më të lartë të posedimit të planeve të qëndrueshmërisë (44%), derisa asnjë organizatë nga Gjilani nuk ka raportuar se ka plan të qëndrueshmërisë. 25% e organizatave nga rajoni i Mitrovicës, 14% nga rajoni i Prizrenit dhe 10% e organizatave nga kryeqyteti deklaruan

se kanë plane të tilla. Siç u theksua më lartw në këtë raport, mungesa e qëndrueshmërisë financiare prodhon efekte të shumëfishta në të gjitha aspektet e qëndrueshmërisë, duke u penguar organizatave të bëjnë plane paraprake. Edhe kur organizatat kanë plane strategjike, për të cilat shumica e organizatave kanë thënë se i kanë në dispozicion, ato janë më shumë një 'listë dëshirash' se planet e njëmendta strategjike për aktivitete, meqë implementimi i tyre varet në masë të madhe nga prioritetet financuese të përcaktuara nga donatorët, ku OShC-të nuk kanë edhe aq ndikim.

A ka organizata juaj Plan të Qëndrueshmërisë?		Rajonet					Gjithsej
		Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Pejës	Rajoni i Prizrenit	Rajoni i Mitrovicës	Rajoni i Gjilanit	
	Po	10.0%	44.4%	14.3%	25.0%		18.2%
	Jo	90.0%	55.6%	85.7%	75.0%	100.0%	81.8%
Gjithsej		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Figura 25: Posedimi i Planit të Qëndrueshmërisë sipas rajonit

2.3.1 Fokusi i synuar i aktiviteteve të ardhshme

Planet për aktivitetet e ardhshme për të cilat tani nuk kanë fonde ekzistojnë te masa dërmuese e organizatave të anketuara. Më se 89% e organizatave të mostrës raportojnë se kanë plane për aktivitete për të cilat nuk kanë fonde. Sërish, organizatat e rajonit të Gjilanit raportojnë shkallë shumë më të ulët planesh për aktivitetet e ardhshme (75%) kundrejt organizatave të rajonit të Prizrenit ku, për shembull, të gjitha organizatat raportojnë plane të tilla. Organizatat nga rajoni i Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicës gjithashtu raportojnë shkallë shumë të lartë planesh në raport me rajonin e Gjilanit me 88%, 89% gjegjësisht 86% të organizatave të anketuara.

Kur u pyetën nëse kanë plane për dyfishimin/zgjerimin e aktiviteteve aktuale në zona/rajone të tjera, 40% të organizatave konfirmuan plane të tilla, 50% prej tyre mohojnë të kenë plane të tilla për zgjerim të fokusit të tyre gjeografik, derisa 12% e organizatave kanë zgjedhur opsionin 'nuk është e aplikueshme' (potencialisht pasi që aktivitetet e tyre tashmë zbatohen në mbarë vendin apo në shumë zona). Në këtë drejtim, organizatat e rajonit të Prizrenit raportojnë interesim/synim më të madh për t'i dyfishuar aktivitetet në rajonet e tjera me gjithsej 71% të organizatave që raportojnë plane të tilla. Organizatat e rajonit të Pejës dalin në vendin e dytë sa i përket ambicies për shtrirjen e aktiviteteve edhe në zonat e tjera (60%), derisa 38% e organizatave nga rajoni i Prishtinës raportojnë të njëjtën gjë. Asnjëra prej organizatave nga rajoni i Mitrovicës dhe i Gjilanit nuk kanë raportuar plane

A keni plane për implementimin e aktiviteteve të reja?	Rajonet					Gjithsej
	Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Pejës	Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Mitrovicës	Rajoni i Prishtinës	
Po	88.0%	88.9%	100.0%	85.7%	75.0%	88.5%
Jo	12.0%	11.1%	0.0%	14.3%	25.0%	11.5%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Figura 26: Planet për aktivitetet e ardhshme

për dyfishimin/zgjerimin e aktiviteteve në zonat e tjera.

A ka organizata plane për t'i dyfishuar aktivitetet edhe në zona të tjera?		Rajonet					Gjithsej
		Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Pejës	Rajoni i Prizrenit	Rajoni i Mitrovicës	Rajoni i Gjilanit	
	Po	37.5%	60.0%	71.4%			39.2%
	Jo	37.5%	40.0%	28.6%	100.0%	100.0%	49.0%
	N/A	25.0%					11.8%
Gjithsej		100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Figura 27: Planet për dyfishimin e aktiviteve në zonat e tjera

2.4 Nevojat për zhvillimin e kapaciteteve

2.4.1 Ekspertiza dhe trajnimi

Formulimi dhe analizat e politikave lokale është fusha e parë e ekspertizës dhe trajnimit për të cilën u parashtrua pyetja. Në këtë aspekt, përqindja më e madhe e organizatave të cilat konfirmojnë nevojën për zhvillimin e kapaciteteve për formulimin/analizën e politikave lokale vijnë nga rajoni i Prishtinës, ku 63% e organizatave e identifikojnë këtë prioritet. Organizatat e rajonit të Pejës përbëjnë 25% të organizatave që konfirmojnë nevojën për zhvillimin e kapaciteteve në fushën

e formulimit të politikave, derisa 13% e tyre vijnë nga rajoni i Prizrenit. Asnjë organizatë nga rajoni i Mitrovicës dhe i Gjilanit nuk e ka përzgjedhur këtë fushë prioritare për zhvillimin e kapaciteteve.

Kur ky aspekt analizohet sipas llojit të organizatave, përgjigjja duket të jetë e shpërndarë mjaft barabartë të shumica e kategorive të organizatave. Organizatat rinore dhe ato të grave, organizatat bamirëse dhe shëndetësore, veç e veç përfaqësohen me nga 12.5%. Organizatat *think-tank* dhe ato të artit përfaqësohen me nga 25% në aspektin e identifikimit të kësaj nevoje prioritare për zhvillimin e kapaciteteve.

Formulimi/analiza e politikave lokale	4. Lloji i organizatës						Gjithsej
	OJQ rinore	OJQ e grave	Think Tank	Organizatë humanitare /bamirëse	Shëndetësore	OJQ e artit	
Fushë prioritare	12.5%	12.5%	25.0%	12.5%	12.5%	25.0%	100.0%
Gjithshej	12.5%	12.5%	25.0%	12.5%	12.5%	25.0%	100.0%

Figura 28: Nevojat për formimin/analizën e politikave lokale sipas llojit të organizatës

2.4.2 Zhvillimi institucional

Meqë gati gjysma e organizatave konfirmojnë se nuk kanë plane strategjike, ky prioritet për zhvillimin e kapaciteteve u identifikua si nevojë e një numri të konsiderueshëm të organizatave të anketuara. Në këtë aspekt, organizatat e rajonit të Prishtinës dhe të Pejës përbëjnë më shumë se 50% të organizatave të mostrës të cilat e kanë përzgjedhur këtë prioritet si nevojë të tyre. OShC-të nga rajoni i Prizrenit dhe i Mitrovicës përfaqësohen me nga 18% në këtë mostër, derisa rajoni i Gjilanit paraqitet me 11% të të gjitha organizatave që theksojnë nevojën për zhvillimin e

kapaciteteve. Figura 25 jep një pasqyrë të përgjigjeve të kësaj pyetjeje sipas rajonit.

Nevojat për planifikim strategjik sipas rajonit




Figura 29: Nevojat për planifikim strategjik sipas rajonit

Nxjerrja e fondeve është formë tjetër e zhvillimit të kapaciteteve e cila është e nevojshme për zhvillimin e mirëfilltë institucional të organizatave. Në këtë aspekt, duke marrë parasysh ndryshimin dhe ndërlikimin e vazhdueshëm të procedurave të aplikimit nga organizatat donatore, shumica e organizatave në Kosovë do të përfitonin nga ndonjë lloj trajnimi për nxjerrjen e fondeve. Derisa disa organizata janë shumë më të avancuara në këtë aspekt, nevojat e tyre për zhvillimin e kapaciteteve për krijimin e fondeve janë të dukshme. Edhe disa prej organizatave më të mëdha në Kosovë angazhojnë konsulentë të jashtëm e kompani për shërbime të nxjerrjes të fondeve, duke dëshmuar kështu mungesën e qartë të kapaciteteve në këtë fushë. Nga organizatat e anketuara të cilat kanë identifikuar nevojën për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e nxjerrjes së fondeve, më shumë se 33% e tyre vijnë nga rajoni i Prishtinës, 30% nga rajoni i Pejës, 15% nga rajoni i Mitrovicës, 12% nga rajoni i Gjilanit dhe vetëm 9% nga rajoni i Prizrenit. Një përbërje e tillë e përgjigjeve sipas rajonit është në vijë me përgjigjet e marra sa i përket posedimit të planit strategjik.

Aspekti tjetër që ishte pjesë e anketës kishte të bënte me adoptimin e teknologjive të reja. Në këtë aspekt, organizatat e shohin nevojën për

adoptimin e teknologjive të reja. Ky lloj i zhvillimit të kapaciteteve gjithashtu paraqitet te shumica e rajoneve të anketuara dhe llojet e organizatave. Kështu, vetëm organizatat e rajonit të Gjilanit nuk e kanë identifikuar adoptimin e teknologjive të reja si nevojë për zhvillimin e kapaciteteve.

Adaptimi i teknologjive të reja




Figura 30: Adoptimi i teknologjive të reja

Menaxhimi dhe zbatimi i projekteve dhe programeve gjithashtu paraqet nevojë e cila është treguar relevante në këtë vlerësim. Kësisoj, OShC-të në masë të madhe e shohin nevojën për menaxhim të mirëfilltë të projekteve gjatë fazës së zbatimit të aktiviteteve. Përgjigjet e marra tregojnë se si shtrirja rajonale ashtu edhe ajo përgjatë llojeve të

ndryshme të organizatave është mjaft e gjerë, duke dëshmuar kështu nevojën për zhvillimin e kapaciteteve në këtë fushë. Shikuar nga aspekti gjeografik, organizatat e rajonit të Prishtinës të cilat theksojnë këtë nevojë për zhvillimin e kapaciteteve japin pjesën më të madhe të përgjigjeve në këtë mostër, me mbi 46% të organizatave që japin këtë përgjigje. Organizatat e rajonit të Pejës dhe të Mitrovicës paraqiten me nga 16% që raportojnë këtë nevojë, derisa organizatat e rajonit të Prizrenit dhe të Gjilanit këtë përgjigje e japin në masën 12%.

Shpërndarja e përgjigjeve është gjithashtu mjaft lineare kur ato analizohen sipas llojit të organizatës. Kështu, të gjitha llojet e organizatave në këtë mostër raportojnë nevojën për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e menaxhimit dhe të zbatimit të projekteve. Meqë kërkesat e organizatave donatore (duke përfshirë fondacionet vendore) po bëhen gjithnjë e më të ndërlikuara dhe me standarde më të larta, nevoja për këtë lloj të zhvillimit të kapaciteteve bëhet e dukshme.

Menaxhimi dhe zbatimi




Figura 31: Menaxhimi dhe zbatimi sipas rajonit

Menaxhimi dhe zbatimi sipas llojit të organizatës




Figura 32: Menaxhimi dhe zbatimi sipas llojit të organizatës

3.1 Përfundimet dhe rrjedha e sugjeruar e veprimit

Në pajtim me detyrat e punës së këtij vlerësimi, këtu jepet një pasqyrë e përfundimeve dhe rekomandimeve kyçe në bazë të gjetjeve dhe rezultateve të hulumtimit. Kësisoj, përfundimet dhe rekomandimet janë të hartuara me qëllim të mënjanimit të pengesave aktuale dhe të ardhshme për një mjedis energjik dhe të përshtatshëm që nxit aktivizëm. Ato kanë për qëllim ta shumëfishojnë efikasitetin e mbështetjes e cila do t'u ofrohet OShC-ve nga projekti GRAS, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i implementuar nga IKS-ja, si në aspektin e mbështetjes me fonde ashtu edhe në aspektin e zhvillimit të kapaciteteve. Ky vështrim mbulon kapacitetet e OShC-ve, planet dhe situatën aktuale për të nxjerrë në pah vijat e trasha dhe faktorët të cilët mund të ndikojnë në efektivitetin e dhënies së mbështetjes. Megjithëse kësaj liste mund t'i shtohen edhe shumë përfundime dhe rekomandime të tjera në fazën përcjellëse, këto që vijojnë paraqesin aspektet më të rëndësishme të sugjeruara të cilat duhet të merren parasysh gjatë fazës së përfundimit të dizajnit të

mbështetjes për organizatat lokale dhe ato me bazë në komunitet.

Komentet e përgjithshme

Përfundimi 1: Njëra prej pengesave më të vështira të kapaciteteve që duhet tejkaluar ka të bëjë me aftësinë e organizatave të mbajnë staf me orar të plotë në pozita të përhershme. Kjo vjen si rrjedhojë e financimit të bazuar në projekte nga i cili varet shumica e organizatave. Si pasojë e kësaj, ato nuk janë në gjendje të krijojnë burime njerëzore, të grumbullojnë njohuri dhe ekspertizë, dhe ta avancojnë veprimtarinë e tyre. Avokimi, formulimi i politikave dhe monitorimi janë aktivitete të vazhdueshme ditore të cilat kërkojnë vëmendje dhe përpjekje të vazhdueshme. Andaj, ndërprerja e financimit si pasojë prodhon ndërprerjen e angazhimit të stafit dhe ndërprerjen e pjesëmarrjes së OShC-ve në këto procese. Si pasojë direkte, proceset janë sipërfaqësore, mospërfshirëse, dhe pa pjesëmarrjen e publikut. Deri më tani janë investuar përpjekje të mëdha për zhvillimin e kapaciteteve (trajnime) nga organizatat e ndryshme donatore dhe ai efekt i vogël mund të vërehet te OShC-të sa i përket qëndrueshmërisë, por efekti i gjithëmbarshtëm i zhvillimit të kapaciteteve ruhet përbrenda sistemit.

Veprimi i rekomanduar: Aktivitetet e vazhdueshme të dhënies së granteve

dhe zhvillimi i kapaciteteve të OShC-ve lokale janë të domosdoshme për të pasur një sektor energjik i cili ka kapacitete të nevojshme për t'i adresuar me sukses sfidat lokale. Edhe pse lëvizja e stafit dhe e ekspertizës nga njëra organizatë te tjetra apo nga njëri sektor te tjetri duhet pranuar si fakt, përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve të tyre nuk duhet të konsiderohen të humbura. Përkundrazi, duhet konsideruar se zhvillimi i kapaciteteve ka prodhuar efekte të shumëfishta në sektorët e tjerë të cilët gjithashtu kanë nevojë të madhe për burime profesionale njerëzore.

Përfundimi 2: Llojllojshmëria e organizatave sa i përket madhësisë, temave dhe sektorëve të mbuluar është mjaft e theksuar sa të mundësojë opsione fleksibile dizajnimi edhe sa i përket mbështetjes financiare dhe në aspektin e zhvillimit të kapaciteteve. Projekti GRAS, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i implementuar nga IKS-ja mund ta sajojë mbështetjen si për organizatat më të zhvilluara me kapacitete më të mëdha ashtu edhe për organizatat më të vogla, dhe mbështetja nevojitet nga të dy grupet e synuara. Megjithatë, nuk ka nevojë të kufizohet skema brenda vetëm një grupi të synuar.

Veprimi i rekomanduar: Skema e grantit mund të përfshijë grante të disa madhësive të përshtatura në vijë me

kapacitetet si të organizatave të mëdha ashtu edhe të atyre të vogla, duke ofruar kështu mundësi për të gjitha organizatat e interesuara t'i arrijnë objektivat e GRAS-it. Për sa i takon zhvillimit të kapaciteteve, dy opsionet janë:

- 1) të ofrohet zhvillimi i mirëfilltë i kapaciteteve i cili është aq fleksibil sa t'u përshtatet niveleve të ndryshme të njohurive dhe të përvojave të organizatave pjesëmarrëse; ose,
- 2) të ofrohen disa nivele trajnimi me temën e njëjtë (d.m.th. kurset fillestare, të ndërmjetme, të avancuara).

Organizatat përzgjedhen përmes thirrjes publike për propozime, dhe nuk ekziston mënyra për të vlerësuar nivelin e hollësive dhe të përmbajtjes krahas njohurive që janë parakusht i organizatave pjesëmarrëse.

Përfundimi 3: Përbërja e organizatave sa u përket sektorëve, temave dhe prioriteteve që ato përfaqësojnë është mjaft e llojllojshme sa të mundësojë opsione fleksibile dhe përfshirëse të dizajnit të mbështetjes. Organizatat që janë aktive në sektorin e mjedisit mund të përfitojnë po aq sa edhe organizatat rinore, sportive apo organizatat e tjera nga fondet në dispozicion në kuadër të projektit GRAS.

Veprimi i rekomanduar: Rekomandohet që dizajni i skemës së grantit të jetë aq

fleksibil sa të mundësojë një varg të gjatë temash/sectorësh/çështjesh të kualifikueshme të cilat mbulohen me këto grante. Edhe pse objektiva e përgjithshme e mbështetjes financiare duhet të fokusohet në forcimin e përpjekjeve avokuese, sektorët nuk duhet të anashkalohen.

Përfundimet dhe rekomandimet specifike për skemat e granteve

Përfundimi 4: OShC-të kanë njohuri të kufizuara sa i përket procesit të aplikimit, vlerësimit dhe vendimmarrjes në thirrjet konkurruese publike. Ato janë të kufizuara brenda këndvështrimeve të tyre dhe shpeshherë e shpërfillin procesin e aplikimit, objektivat e financimit, kriteret e vlerësimit dhe të ngjashme. Atyre u mungojnë njohuritë themelore lidhur me konceptin të cilin e aplikojnë donatorët e ndryshëm siç është korniza logjike (d.m.th. nuk arrijnë të bëjnë dallimin ndërmjet aktiviteteve, rezultateve e objektivave gjatë formulimit dhe të kuptuarit e konceptit).

Veprimi i rekomanduar: Për ta adresuar këtë pengesë, rekomandohet që gjatë takimeve informuese për programe të ardhshme të dhënies së granteve, t'i kushtohet vëmendje dhe fokus i veçantë procesit të vlerësimit, p.sh. çka do të konsiderojë të rëndësishme komisioni vlerësues, njohuritë

paraprake të vlerësuesve sa i takon një vargu të gjatë temash të mbuluara, etj. Takimet publike me OshC-tw gjithashtu duhet të përdoren për ta shpjeguar procesin e vlerësimit, kriteret dhe objektivat e financimit. Takimet publike rajonale do ta rrisnin mbulueshmërinë dhe do ta përmirësonin vetëdijësimin për mundësitë për grante të ofruara nga projekti GRAS.

Përfundimi 5: Ekziston një keqkuptim në mesin e OShC-ve sa i takon domethënies së komunitetit. Shumë OShC i marrin anëtarët dhe përfituesit e tyre si komunitetin e tyre, pavarësisht faktit se përfituesit janë një grup fluid i cili ndryshon varësisht nga financimi i projektit dhe nuk është i lidhur drejtpërdrejt me misionin e gjithëmbarshtëm. Mungesa e përfshirjes së komunitetit është gjithashtu pjesërisht për shkak të mundësisë së OShC-ve të mbeten financiarisht funksionale vetëm përmes financimit ndërkombëtar dhe lokal. Një arsye për këtë shpeshputje vjen si pasojë e presionit për të qenë jopolitik si dhe për shkak të presionit për të qenë llogaridhënës përpara donatorëve dhe qeverisë e jo përpara përfituesve, derisa këto shpeshherë bphen nw kurriz tw funksionit të një shoqërie civile. Për këtë arsye ndërtimi i komunitetit shërben si një funksion i rëndësishëm i qëndrueshmërisë: pa

lidhje me komunitete, apo pa popullsinë e cila drejtpërdrejt dhe vazhdimisht angazhohet me një organizatë, OShC-ja do të shuhej nëse do të ndërpritej financimi.

Veprimi i rekomanduar: Mangësia sa i takon zhvillimit të komunitetit kërkon strategji të qëndrueshme të ndërtimit të komunitetit. Sidoqoftë, mbështetja financiare afatshkurtë dhe mentorimi nga ana e organizatave të cilat ofrojnë mbështetje të tillë të paktën do t'i kontribuonte në fillim ngritjes së të kuptuarit të konceptit të komunitetit, për të ndërmarrë më pas hapa të tjerë drejt zhvillimit të mëtutjeshëm të komunitetit.

Përfundimi 6: Nuk ka përfshirje të sektorit të tregtisë dhe industrisë në çështjet e OShC-ve dhe në zgjidhjen e tyre. Derisa trendet globale sjellin partneritete ndërsektoriale dhe përfshirje të kapitalit privat në krijimin e mundësive ekonomike, ku aktualisht ekzistojnë sfidat, ky aspekt në Kosovë ka qenë mjaft i kufizuar. Në shumë sektorë, temat, çështjet, akterët e tregtisë dhe të industrisë, janë lojtarët kyçë që shpesh shpërfillen nga OShC-të. Shembuj të tillë mund të jepen në shumë sektorë siç është mjedisi dhe

zhvillimi i qëndrueshëm³⁴, antikorrupsioni³⁵, sportet³⁶ e artet³⁷.

Veprimi i rekomanduar: Rritja e përfshirjes së sektorit privat (tregtia dhe industria) në aktivitetet e ardhshme duhet të nxitet në veçanti me skemën e granteve. Ky aspekt (partneriteti ndërsektorial) është i vetmi Qëllim i Zhvillimit të Qëndrueshëm i cili nuk u adresua fare në Kosovë. SDG 17: Revitalizimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm u shpërfill plotësisht në Kosovë, derisa ky është trendi kryesor global i rëndësisë më të madhe. Partneritetet e zhvilluara gjithashtu do të krijojnë hapësirë për shfrytëzimin e ndryshimeve aktuale legjislative për donacionet e korporatave, ku sektori privat mund të japë donacion deri në 10% të fitimit për rini, sport e kulturë.

Përfundimi 7: Vullnetarizmi është aspekti kyç i punës dhe i angazhimit për organizatat lokale, sidomos ato të synuara me projektin GRAS. Shumica e organizatave raportojnë se u mungon mobilizimi i vullnetarëve për çështjet dhe aktivitetet e tyre. Angazhimi për mbështetjen e komunitetit është parakusht kryesor për qëndrueshmërinë e aktiviteteteve, meqë nga kjo varet pronësia mbi rezultatet,

³⁴ C&I burimi i problemit por gjithashtu zgjidhja

³⁵ C&I në anën e dhënies

³⁶ Klubet kanë trajtuar të njëjten politikë pavarësisht nëse janë OSHC ose biznese private

³⁷ MYC thirrjet

shpesh janë universale, përfshirë individë, grupe, subjekte të regjistruara dhe të paregjistruara, publike, private dhe jo-fitimprurëse

qëndrueshmëria e jetëgjatësia e tyre, si dhe ndikimi i gjithëmbarshtëm. Angazhimi vullnetar gjithashtu ndikon në gjithëpërfshirje, që aq shumë nevojitet në të gjithë sektorët në Kosovë.

Veprimi i rekomanduar: Rekomandohet fuqishëm që skema e grantit t'u japë pikë bonus propozimeve për projekte të cilat përfshijnë komponentën e vullnetarizmit. Kushtëzimi i granteve (apo dhënia e pikëve shtesë) për organizata të cilat kanë komponentën e angazhimit vullnetar do ta rriste gjithashtu ndikimin horizontal dhe mbulueshmërinë e investimit të GRAS-it, duke prodhuar kësajsoj efekt të shumëfishtë me bazë në komunitet në të gjithë sektorët dhe temat. Angazhimi lokal është njëri prej përbërësve më të nevojshëm që çështjet e OShC-ve të marrin mbështetje të gjithëmbarshme si në nivel lokal ashtu edhe në atë nacional. Përfshirja e vullnetarëve gjithashtu i rrit gjasat e mbështetjes lokale përmes kontributit apo barazvlerës së tij në kesh, për nisma të cilat ata i konsiderojnë si të tyre. Krijimi i grupeve, që shihet si dobësi e përgjithshme në gjithë shoqërinë civile, do të lehtësohej në masë të madhe përmes angazhimit vullnetar. Zhvillimi i kapaciteteve për angazhimin dhe menaxhimin e vullnetarëve gjithashtu do ta përmirësonte dukshëm aftësinë e OShC-ve të rekrutojnë vullnetarë.

Përfundimi 8: Ekipi gjithashtu ka ardhur në përfundim se OShC-të nuk kanë shumë njohuri për Procesin e Anëtarësimit në BE, për mekanizmat që sjell faza e Paraanëtarësimit, si dhe për Kornizën Legjislative Acquis të BE-së. Ato po ashtu nuk janë përgjithësisht aktive sa i përket dërgimit të komenteve për Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, që përbën njërin prej mjeteve më efektive të avokimit që aktualisht janë në dispozicion në Kosovë.

Veprimi i rekomanduar: Rekomandohet fuqishëm që të mbështeten punëtoritë tematike sektoriale për orientimin e kontributit të OShC-ve në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian. Organizimi i grupeve punuese/punëtorive me OShC-tw rreth temave sipas strukturës së Raportit të Progresit do t'i rriste në mënyrë të konsiderueshme përpjekjet avokuese në nivel lokal dhe atë nacional, dhe do t'i shumëfishonte sinergjitë ndërmjet nismave të ndryshme.

Përfundimi 9: Shumica e OShC-ve raportojnë se kanë modele të realizueshme të cilat ata synojnë t'i dyfishojnë në rajonet/zonat e tjera gjeografike. Derisa shumica e OShC-ve gjithashtu raportojnë se kanë projekte të reja për implementim nëse sigurojnë fonde, një numër shumë më i madh i organizatave raportojnë se aktivitetet e

tyre do t'i drejtonin/dyfishonin tjetërkund.

Veprimi i rekomanduar: Rekomandohet fuqishëm që projekti GRAS të nxisë dyfishimin e storieve të kaluara të suksesit dhe t'i shtrijë nismat që aktualisht janë të pranishme në zonat e kufizuara gjeografike. Kjo e shumëfishon efikasitetin e OShC-ve dhe i kapitalizon njohuritë e grumbulluara. Kjo gjithashtu e zvogëlon rrezikun për donatorin gjatë fazës së implementimit, meqë organizatat kanë implementuar aktivitete në mënyrë identike dhe e kanë dokumentuar një përvojë të tillë. Kjo gjithashtu nënkupton rritje të efikasitetit në planifikim dhe shfrytëzim të resurseve, duke e shumëfishuar kësaj investimin e projektit GRAS.

Rekomandimet specifike për zhvillimin e kapaciteteve

Përfundimi 10: Shumica e organizatave raportojnë se e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në baza ad-hoc me shumë pak planifikim paraprak të aktiviteteve dhe të resurseve. Ato përgjithësisht i përgjigjen secilës mundësi të aplikimit për të cilën njoftohen, dhe raportojnë se kanë sukses mjaft të vogël kundrejt përpjekjeve për aplikim.

Veprimi i rekomanduar: Duhet të shqyrtohet planifikimi dhe ofrimi i

punëtorive për OshC-tw rreth: Planifikimit Strategjik, Monitorimit dhe Vlerësimit, Ngritjen e Fondeve, dhe Marrëdhëniet me Publikun. Këto aspekte mund t'i përmirësojnë dukshëm kapacitetet planifikuese të organizatave, t'i strukturojnë burimet e tyre dhe të pozicionohen në mënyrë të duhur për periudha më të gjata kohore. Kjo do ta përmirësonte dukshëm qëndrueshmërinë e organizatës, do t'ua shtonte ekspertizën dhe do të siguronte praninë e OShC-ve në tema, sektorë e çështje. Përveç kësaj, hartimi dhe shpërndarja e "Adresarit të Donatorëve" me të gjitha burimet e fondeve në dispozicion, procedurat e aplikimit dhe afatet, objektivat e financimit etj. si pjesë e përpjekjeve për edukim/zhvillim të kapaciteteve dhe shpërndarje të gjerë tek organizatat e shoqërisë civile do ta rriste efikasitetin e tyre të ngritjes së fondeve dhe do t'i alokonte resurset adekuate me kohë.

Përfundimi 11: Pak njohuri dhe ekspertizë raportohet në lidhje me zhvillimin, menaxhimin dhe vlerësimin e projektit. Ka një keqkuptim të theksuar madje edhe për konceptet themelore (d.m.th. objektivat, rezultatet, aktivitetet) dhe cilësia e aplikacioneve të pranuar nga fondacionet vendore të dhënies së granteve shpesh është nën nivelin e pritur.

Veprimi i rekomanduar: Rekomandohet që si pjesë e zhvillimit të kapaciteteve,

të dizajnohen dhe të ofrohen trajnime teknike me fokus në Planifikimin e orientuar drejt rezultateve dhe sidomos në **Kornizën logjike**. Ky mjet me variacione të ndryshme përdoret nga shumica e organizatave donatore në Kosovë, duke krijuar kështu efekte edhe në programet e tjera. Ndikimi i një zhvillimi të tillë të kapaciteteve do të ishte më i madh për projektin GRAS nëse do të mund të parashikohej para lansimit të thirrjes për propozime.

Përfundimi 12: Organizatat kanë njohuri shumë të kufizuara sa i përket këndvështrimit të akterëve të tjerë relevantë dhe të proceseve të nevojshme për të bërë ndryshime (d.m.th. sektori privat, komuna, qeveria, kuvendi). Ato nuk arrijnë as t'i shohin dhe t'i përfshijnë proceset e tjera të cilat ndodhin paralelisht me ato në të cilat janë të angazhuara, dhe nuk janë të vetëdijshme për mënyrën se si ato procese ndikojnë në punën e tyre. Atyre u mungon një pikëpamje më komplekse e proceseve përtej angazhimit të tyre direkt dhe paradigmave konkurruese në qeverisje, shoqëri, ekonomi e politikë.

Veprimi i rekomanduar: Për ta adresuar këtë pengesë, ekipi rekomandon ofrimin e trajnimit dhe mentorimit për

formulimin e politikave, analizave dhe ndryshimeve. Një trajnim i tillë do të duhej të sajohet për t'i njoftuar organizatat me bazat e formulimit të politikave/proceseve të ndryshimit dhe për mënyrën se si duhet ta monitorojnë ndikimin në punën e tyre. Zhvillimi i kapaciteteve për avokim dhe lobim për prioritetizimin e çështjeve përpara vendimmarrësve do ta rriste dukshëm aftësinë e OShC-ve të avokojnë në mënyrë efektive për politika më aktive dhe më të gjera, dhe për zbatimin e tyre.

Sa i përket Përfundimit 7: Shih përfundimet paraprake rreth mungesës së njohurive lidhur me mekanizmat e BE-së.

Veprimi i rekomanduar: Projekti GRAS duhet të shfrytëzojë zhvillimin e kapaciteteve dhe të rrisë vetëdijen lidhur me procesin e integritetit në BE si mjet avokimi. Rritja e njohurive të OShC-ve lidhur me mekanizmat e Bashkimit Evropian është intervenimi strategjik kyç i cili është i nevojshëm për t'u mundësuar OShC-ve të jenë pjesë efektive e procesit të integritetit në BE dhe për t'i përmirësuar përpjekjet e tyre avokuese.

BIBLIOGRAFIA

Ary Burger and Paul Dekker with Tymen van der Ploeg and Wino van Veen. Sektor i jofitimprurës në Holandë. Dokument i punës 70. Sociaal en Cultureel Planbureau. Den Haag, April 200. Gjendet në:

<https://www.scp.nl/dsresource?objectid=316d28b5-799a-4acb-8392-cca00cdfb86b&type=org>.

Versioni i konsoliduar i Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian – Pjesa e Tretë: Politikat e Unionit dhe Veprimet e Brendshme – Titulli VII: Rregullat e Përbashkëta për Konkurrencë, Tatim dhe Përafrim të Ligjeve – Kapitulli 1: Rregullat e konkurrencës – Pjesa 2: Grantet e dhëna nga Shtetet – Neni 107 (dikur Neni 87 TEC). Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:12008E107&from=EN>

Qeveria kroate. Rregullorja për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit dhe të kontraktimit të programeve me interes të publikut të implementuara nga shoqatat (Gazeta Zyrtare, nr. 26/15, kroatisht). Gjendet në: http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2015_03_26_546.html

Qeveria kroate. Rregullorja për menaxhimin financiar dhe sistemin e kontrollit, hartimin dhe implementimin e planeve financiare për organizatat jofitimprurëse (Gazeta Zyrtare, nr. 119/15 – kroatisht) Gjendet në: http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2015_10_11_9_2255.html

Direktiva e Komisionit Evropian 2007/66/EC amendamentet e Direktivave 89/665/EEC dhe 92/13/EEC lidhur me përmirësimin e efikasitetit të procedurave të shqyrtimit sa i përket dhënies së kontratave publike (Direktiva e Procedurave të Shqyrtimit të Kontratave Publike). Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/ALL/?uri=CELEX:32007L0066>

Desku i Shoqërisë Civile i BE-së që thirret në Fjalorin e Shoqërisë Civile, London: Routledge, 2005 me autorë Anheier, H./List, R., Gjendet në: https://webgate.ec.europa.eu/fpfis/mwis/aidco/index.php/Grassroots_organisation

Direktiva e Komisionit Evropian 2006/111/EC e 16 nëntorit 2006 për transparencën e marrëdhënieve financiare ndërmjet Shteteve Anëtare dhe nismave publike si dhe për

transparencën financiare brenda nismave të caktuara. Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32006L0111&from=EN>

Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 360/2012 e datës 25 prill 2012 për zbatimin e Nenit 107 dhe 108 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian për të deminimizuar grantet për nismat që ofrojnë shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik. Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32012R0360&from=EN>

Komisioni Evropian. Korniza Kualitative për Shërbime të Interesit të Përgjithshëm në Europë. Komunikata e Komisionit në Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve. Gjendet në: http://ec.europa.eu/archives/commission_2010-2014/president/news/speeches-statements/pdf/20111220_1_en.pdf

Komisioni Evropian. Legjislacioni i BE-së për Shërbimet Publike (Shërbimet me Interes të Përgjithshëm Ekonomik). Gjendet në: http://ec.europa.eu/competition/state_aid/legislation/sgei.html

Komisioni Evropian. Shërbimet Sociale me Interes të Përgjithshëm: Punësimi, Çështjet Sociale, dhe Përfshirja. Gjendet në: <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=794&langId=en>

Komisioni Evropian. Udhëzues për aplikimin e rregullave të BE-së për ndihmën shtetërore, prokurimin publik, dhe tregun e brendshëm të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, dhe sidomos të shërbimeve sociale me interes të përgjithshëm. Dokument i Punës së Stafit të Komisionit. Gjendet në: http://ec.europa.eu/competition/state_aid/overview/new_guide_eu_rules_procurement_en.pdf

Komisioni Evropian. Viti Evropian i Vullnetarizmit 2011. <http://ec.europa.eu/archives/volunteering/en/home2.html>
Liri në Botë 2018: Demokracia në Krizë. Indeksi Global i Demokracisë i Freedom-House 2018. Gjendet në: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/freedom-world-2018>

Forumi Për Iniciativa Qytetare (FIQ). Raport analitik i legjislacionit lidhur me filantropinë në Kosovë. Nëntor 2015. Gjendet në: https://www.fiq-fci.org/file/repository/Raport_analitik_lidhur_me_legjislacionin_qe_ka_te_beje

[me filantropine ne Kosove nentor 2015 820508.pdf](#)

Qeveria e Kosovës, Raporti i Mbështetjes Financiare Publike për OJQ-të nga institucionet e Republikës së Kosovës për periudhën 2015-2016, Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të Mirë, mars 2017.

KCSF Indeksi i Qëndrueshmërisë së Shoqërisë Civile 2016. Prishtinë, tetor 2016. Gjetet në:
http://kcsfoundation.org/repository/docs/05_11_2016_3646225_Indeksi_Kosovar_i_Shoqerise_Civile_2016_KCSF.PDF
 and metadata
<http://kcsfoundation.org/index2016/>

KCSF. Matrica e Monitorimit rreth Mjedisit Mbështetës për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. Raporti për Kosovën 2016. Gjetet në:
http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/16_04_2018_6592658_Monitoring_Matrix_Kosovo_Report_2016.pdf

Instituti KIPRED. Përgjigja ndaj Shpërlarjes së Parave në Kosovë: Politikat dhe Praktikë. Dokument i Politikave Nr. 2/16, mars 2016. Gjetet në:
http://www.kipred.org/repository/docs/Money_Laundering_Response_in_Kosovo_In_between_Policy_and_Practice_FINAL_588142.pdf.

Lancet. Kontraktimi i OJQ-ve për të ofruar kujdes shëndetësor në vendet në zhvillim i përmirëson shërbimet. Publikimi më 5 gusht, 2005. Gjetet në:
https://www.eurekalert.org/pub_releases/2005-08/l-cnt081705.php

Ministria e Administratës Publike, Departamenti i OJQ-ve, portali i OShC-ve. Gjetet në: <https://ojq.rks-gov.net/Login2.aspx>

Nicola Pesaresi, Adinda Sinnaeve, Valérie Guigue-Koeppen, Joachim Wiemann, Madalina Radulescu. Rregullat e Reja të Shtetit për Shërbimet me Interes të Përgjithshëm Ekonomik. Gjetet në:
http://ec.europa.eu/competition/publications/cpn/2012_1_9_en.pdf

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2447>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-057 për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2764>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 03/L-022 për Mbështetjen Materiale për Familjet me

Fëmijët me Paaftësi të Përhershme.
Gjendet në:
http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=260&Itemid=28&lang=en

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin dhe Llogaridhënien e Financave Publike:
http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=141&Itemid=56&lang=en

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. Gjendet në:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 03/L-049 për Financimin e Qeverisjes Lokale. Gjendet në: http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=142&Itemid=56&lang=en

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Menaxhimin dhe Llogaridhënien e Financave Publike. Pjesa IX, Kufizimet lidhur me Huazimin, Dhënien, Huadhënien, Kapitalizmin, Donacionet dhe Subvencionet. Gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2524>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 për Kriteret, Stadardet, dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve. Gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14831>

Qosaj-Mustafa, Ariana dhe Selvete Dibrani. Pasqyrë e Legjislacionit Primar dhe Sekondar lidhur me Decentralizimin e Shërbimeve Sociale në Kosovë. Nëntor 2015. Mbështetja e BE-së për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për Forcimin e Mekanizmave për Implementimin e Decentralizimit të Shërbimeve Sociale. Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Sergii Lukashov, Blerta Perolli, Gani Luga. Databaza (Harta) e Shërbimeve Sociale në nivel rajonal në Kosovë. Mbështetja e BE-së për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për Forcimin e Mekanizmave për Implementimin e Decentralizimit të Shërbimeve Sociale. Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Shaipi, Kushtrim. Vlerësimi i Sfidave dhe Mundësive për Kontraktimin e OShC-ve për të ofruar Shërbime Publike në Kosovë. Projekti i Mbështetjes për Implementimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile.

Prishtinë, qershor 2017. Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Platforma Sociale. Prokurimi Publik për Zhvillim Social: doracak për Direktivën e Prokurimit Publik të BE-së. Gjendet në: http://www.socialplatform.org/wp-content/uploads/2015/10/Public_procurement_for_social_progress.pdf

Drejt një Mjedisi Mbështetës për Shoqërinë Civile. Deklarata e Konferencës së Gjashtëmbëdhjetë të Filantropisë Johns Hopkins, Nairobi, Kenia. Gazeta Ndërkombëtare e Ligjit Jofitimprurës, Vëllimi 8, Numri 1, nëntor 2005.

USAID CSO Indeksi i Qëndrueshmërisë për Kosovën 2005 – 2017. Gjendet në: <https://www.usaid.gov/europe-urasia-civil-society>.

SHTOJCA 1: PYETËSORI

Hulumtim për OSHC-të dhe Organizatat e tjera me bazë në Komunitet për projektin GrassRoots Action Support-GRAS

PYETËSOR

Pyetëtori #_ _ _ _ _

(Intervistuesi lexon deklaratën vijuese)

I nderuari drejtues i OSHC-së (me emër) _____.

Unë jam _____ dhe punoj për AnketaCo, një kompani hulumtuese nga Prishtina. Ky studim është porositur nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) si pjesë e projektit të financuar nga BE "GrassRoots Action Support-GRAS". Qëllimi i tij është të mbledhë informacione mbi situatën në komunat e Kosovës rreth aktiviteteve të OSHC-së, në bazë të të cilave do të zhvillohet dhe zbatohet një skemë e mbështetjes financiare dhe asistencës teknike. Ju lutemi të ndani rreth 20 minuta nga koha juaj dhe të na ndihmoni ta përfundojmë këtë detyrë, dhe të ndihmojmë projektin GRAS të zhvillojë skemën e granteve në bazë të nevojave tuaja. Informacioni që jepni **NUK DO** të përdoret ose paraqitet në mënyrë individuale, por vetëm në formë të agreguar, së bashku me informacionet e ofruara nga organizata të tjera. Nëse keni pyetje shtesë mbi përdorimin ose menaxhimin e informacionit, unë mund t'ju lidh drejtpërdrejtë me menaxherin tim dhe ajo do të jetë në gjendje të ofrojë informata shtesë.

Ju falënderojmë paraprakisht për kohën tuaj dhe vlerësojmë kontributin tuaj.

Informatat Bazë të Organizatës	
1. Emri i organizatës:	
2. A. Lokacioni: qyteti _____ 2.B Rajoni (Qendër, Lindje, Perëndim, Veri, Jug)	
3. Statusi ligjor (Fondacion Lokal, Shoqatë Lokale):	
4. Viti i Themelimit:	
5. Emri i Kryesuesit të Bordit:	
6. Emri i Drejtorit Ekzekutiv:	
7. Emri dhe pozita e personit kontaktues:	
8. Telefoni:	9. Email:
10. Uebsite:	

11. Shtrirja gjeografike (Ku zbatoni shumicën e aktiviteteve):						
a. Ndërkombëtar						
b. Rajonal						
c. Kombëtar						
d. Nënkombëtar/Rajonal						
e. Lokal//Komunal						
12. Ku janë hapësirat e tjera të organizatës (nëse ka)? (Emri i vendit dhe GPS Lokacioni)						
13. Emrat e themeluesve të organizatës:						
a. _____			d. _____			
b. _____			e. _____			
c. _____			f. _____			
14. Cili është misioni i organizatës?						
Sistemi i Menaxhimit						
15. Numri i anëtarëve të bordit:						
15.a. # Burra		15.b. # Gra			15.c. total # n bord:	
16. Numri i anëtarëve të bordit nën moshën 35 vjeç?						
17. A është Kryesuesi i Bordit apo anëtarëve ekzekutivë nën moshën 35 vjeç?						
18. A keni Kuvend/asamble të anëtarëve? a. Po b. Jo						
19. (Nëse po) Sa shpesh organizon mbledhje?						
a. Disa here gjatë vitit						
b. Të paktën një here në vit						
c. Më rrallë se një here në vit						
d. Rrallë ose asnjëherë						
e. Nuk aplikohet						
20. Numri total i stafit sipas kategorisë sipas vitit aktual dhe viteve paraprake						
	a. 2018		b. 2017		c. 2016	
	Total	Gra	Total	Gra	Total	Gra
a.	Orar të plotë					
b.	Orar të pjesshëm					
c.	Vullnetarë					
21. Cilat janë departamentet ekzistuese të organizatës? (listoni) (shtoni nëse ka nevojë)						
a. _____						
b. _____						
c. _____						
d. _____						
Programet ekzistuese						
22. Cili është fokusi i programeve aktuale (mund të përzgjedhet më shumë se një)?						
Avokim dhe Lobim						
Barazi Gjinore						
Edukim/Trajnim						
Përkujdesje Shëndetësore						
Punësim						
Sipermarrje Sociale						
Vullnetarizem						

Ndihmë Personave me Nevoja të Veçanta Të Drejta të Njeriut Pjesëmarrje Qytetare Përfshirje Sociale Trashëgimi Kulturorë Kulturë/Sport/Rini Demokratizim Tjera (specifiko) _____		
23. A keni anëtarë/ përkrahës?	a. Po	b. Jo
24. Si do ti definonit anëtarët/konstituencat/përkrahësit/grupet që përfaqësoni?		
25. A marrin pjesë grupet/përkrahësit e cekur në planifikim të programeve tuaja?		
a. Po b. Jo		
26. (Nëse po) si marrin pjesë ata/ato?		
27. Sa anëtarë të këtyre grupeve kanë marrë pjesë në aktivitetet tuaja në vitin e fundit?		
28. Cilat janë aktivitetet tuaja bazike? (p.sh. çdo aktivitet që nuk varet nga fondet e donatorëve)?		
a. _____		
b. _____		
c. _____		
d. Të gjitha aktivitetet varen nga fondet e donatorëve		
29. Totali i portfolit të projekteve aktive në euro:		
30. Numri total i projekteve aktive:		
31. Kur përfundon projekti juaj i fundit (që përfundon më së largu) aktiv:		
32. Cfarë lloje të aktiviteteve zbatoni aktualisht: (Ju lutem listoni)		
1. _____		
2. _____		
3. _____		
4. _____		
5. _____		
32. A keni në plan të implementoni aktivitete të reja? a. Po b. Jo		
33. (Nëse po) listoni llojet e aktiviteteve të planifikuara për të cilat keni nevojë për fonde:		
1. _____		
2. _____		
3. _____		
4. _____		
5. _____		
Mundësitë për Vullnetarizëm		
34. A mbështetet organizata juaj tek vullnetarët për kryerjen e aktiviteteve?		
a. Po b. Jo c. Nganjëherë		
35. (Nëse po, ose nganjëherë) çfarë lloje aktivitete kryhen nga vullnetarët?		

36. Mesatarja e vullnetarëve që marrin pjesë në aktivitete për një vit:
37. Si i motivon organizata vullnetarët dhe mirënjeh punën e tyre? a. Letrave të referencës b. Dhurata c. Certifikata falemnderimi d. Pjesëmarrje në punëtori të organizatës e. Shpërblime financiare f. Tjetër: g. N/A
Plani Strategjik
38. A ka organizata plan strategjik? (bashkëngjit nëse ka) a. Po b. Jo
39. (Nëse po) Cila është kohëzgjatja e këtij plani? Deri në vitin_____
40. Kush merr pjesë në planifikim strategjik? (selekto të gjitha që aplikohen) a. Stafi b. Anëtarët e Bordit c. Donatorët d. Grupet e interes/anëtarët/konstituencat/grupet përkrahëse e. Anëtarët votues f. Partnerët g. Tjetër, specifiko_____
41. A ka organizata plan të qëndrueshmërisë? (bashkëngjit nëse ka) a. Po b. Jo
42. Cilat janë grupet e shënjestruara aktualisht nga organizata? (listo) a. Fëmijët dhe adoleshentëve (deri në moshën 18 vjeç) b. Rinia (deri në moshën 29) c. Gratë d. Personat me nevoja të vecanta e. Grupet e cënueshme ³⁸ f. Tjetër, specifiko_____
43. A planifikon organizata të replikojë /zgjerojë aktivitetet në lokacione të tjera? a. Po b. Jo c. N/A
44. Nëse po, ku?_____ b. Nuk aplikohet
45. Nëse organizata planifikin të replikojë/zgjerojë aktivitetet, cili do të jetë modaliteti? a. Franshizë b. Partneritet c. Asistencë teknike për organizata të tjera d. Hapja e degëve të reja e. Tjetër_____
Monitorimi dhe vlerësimi
46. Cfarë aktivitete të monitorimit dhe vlerësimit ndërmerr organizata: a. Në nivel të organizatës b. Në nivel të programit c. Në nivel të projektit d. Asnjë e. Tjetër_____
47. Cfarë indikatorësh përdor organizata për të matur rezultatet?

³⁸ Personat e zhvedosur, komunitetet pakicë, të rinjtë, personat as në shkollim, punësim, apo trajnim (NEETs).

48. Sa shpesh mat organizata rezultatet?						
a. Vazhdimisht, kur janë duke ndodhur						
b. Periodikisht (sipas planeve të monitorimit)						
c. Rrallë						
d. Nuk monitorojmë indikatorë						
e. Nuk aplikohet/ Refuzoj						
Partnerët dhe burimet e financimit						
49. A ka organizata juaj partneritet me organizata te tjera? a. Po b. Jo						
50. (Nëse po), listoni partnerët dhe natyrën e partneritetit (selekto të gjitha që aplikohen)						
a. Fonde						
b. Zbatim aktivitetesh,						
c. Asistencë teknike,						
d. Sensibilizim/informim,						
e. Rrjetëzim i bazuar në projekte,						
f. Tjetër, specifiko_____						
g. Nuk aplikohet						
51. Me qëllim të ndikimit të politikave publike sa shpesh:						
#	Veprimi/iniciativa	Disa here në muaj	Mesatarisht 1 herë në muaj	Disa herë në vit	Mesatarisht 1 herë në vit	Asnjëherë
A	Takoheni me përfaqësuesit e komunës / këshilltarët e kuvendit komunal?					
B	Monitoroni punën e kuvendit komunal / grupeve punuese, etj					
C	Dërgoni letra / Pyetje publike					
D	Merrni pjesë në dëgjime publike					
E	Nënshkruani peticione					
F	Dërgoni komente në raportin e progresit të BE-së					
52. Sa jeni të kënaqur me aspektet vijuese të bashkëpunimit me autoritetet komunale?						
#	Aspekti	Shumë i /e kënaqur	Më shumë i/e kënaqur se i/e pakënaqur	Neutral	Më shumë i/e pakënaqur se i/e kënaqur	Shumë i/e pakënaqur

A	Reagueshmërinë / kohën e reagimit ndaj kërkesave tuaja					
B	Transparencën					
C	Pranueshmërinë e nismave nga shoqëria civile dhe qytetarët					
D	Gjithëpërfshirje në procese dhe vendime					
E	Përkrahjen financiare					

53. Në çfarë sektorësh kanë qenë veprimet/iniciativat e sipërme?

#	Veprimi/iniciativa	Sektori/ët
A	Takoheni me përfaqësuesit e komunës / këshilltarët e kuvendit komunal?	1. 2.
B	Monitoroni punën e kuvendit komunal / grupeve punuese, etj	1. 2.
C	Dërgoni letra / Pyetje publike	1. 2.
D	Merrni pjesë në dëgjime publike	1. 2.
E	Nënshkruani peticione	1. 2.
F	Dërgoni komente në raportin e progresit të BE-së	1. 2.

54. Cilat janë burimet aktuale të financimit:

- Institucionet qendrore
- Komunat
- Fondacionet lokale
- Ngjarje dhe bamirësi të tjera
- Kompani private
- Organizatrat ndërkombëtare
- Donacione individuale
- Pagesa të anëtarësisë
- Crowd funding / (përmes platformave online)
- Shërbimet e organizatës
- Tjetër, Specifiko _____

55. A është organizata anëtare në ndonjë rrjet ndërkombëtar ose kombëtar? a. Po b. Jo

56. (Nëse po), ju lutem emëroni ato?

- _____
- _____
- _____

57. Sa është buxheti mesatar vjetor në tre vitet e fundit në EUR? _____ EUR

58. Çfarë përqindje e kostove mbulohet nga të ardhurat vetanake të organizatës? _____%

Resurset e organizatës	
59. A posedon(pronësi) organizata hapësira/zyre? Jo	a. Po ▼ b.
60. Nëse jo, cilat janë aranzhimet kontraktuale? a. Rent, b. Qira pa pagesë c. Marrëveshje me komunën d. Tjetër, specifiko_____	
61. Kush paguan shërbimet komunale? a. Organizata nga burimet vetanake b. Fonde bazike (Core funding) nga organizatë donatore c. Fondet nga projektet d. Tjetër, specifiko_____	
62. Kush paguan pagat e stafit? a. Organizata nga burimet vetanake b. Fonde bazike (Core funding) nga organizatë donatore c. Fondet nga projektet d. Tjetër, specifiko_____	
63. Kush paguan për mirëmbajtje? a. Organizata nga burimet vetanake b. Fonde bazike (Core funding) nga organizatë donatore c. Fondet nga projektet d. Tjetër, specifiko_____	
64. Cilat janë kostot vjetore të ndryshueshme (sipas llojit): a. Stafi: _____ EUR b. Materiale dhe pajisje: _____ EUR c. Rent: _____ EUR d. Shërbime komunale: _____ EUR e. Tjetër, specifiko_____	
65. Çfare resursesh/burimesh fizike ka në dispozicion organizata? a. Bibliotekë b. Laborator kompjuterësh c. Salla trajnimesh d. Pajisje për Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë (STEM) e. Tjetër, specifiko_____	
Nevojat e organizatës	
66. Cilat janë nevojat e organizatës për të ardhmen për sa i përket hapësirës dhe pajisjeve? 1. Pajisje 2. Mobililje/orendi zyre 3. Material teknike 4. Hapësirë shtesë 5. Euro 6. Tjetër, specifiko_____	

SHTOJCA 2: PYETËSORI 2

GrassRoots Action Support-GRAS Survey

Iniciativa Kosovare për Stabilitet është duke zhvilluar një projekt për dhënie të granteve për organizatat e shoqërisë civile me bazë në komunitet por paraprakisht është duke zhvilluar një hulumtim rreth funksionimit të këtyre organizatave. Ju lutem t'i përgjigjeni një pyetësori të përgatitur për këtë qëllim. Pyetësori përmban 13 pyetje dhe nuk merr më shumë se 5 minuta kohë.

Të Dhëna për Organizatën

1. Emri i organizatës

2. Viti i themelimit të organizatës

3. Komuna në të cilën e zhvillon veprimtarinë organizata

4. Web faqja e organizatës/rrjetet sociale

5. Email adresa e organizatës

6. Numri i telefonit të organizatës

Përfshirja e Komunitetit

7. Në çfarë forme komunikoni me komunitetin për t'i identifikuar nevojat e tyre? (p.sh: përmes emailit, përmes takimeve publike apo individuale, telefonatave, anketimeve, etj)

8.A përfshihen nevojat reale të komunitetit në projektet që zhvillohen nga organizata juaj?

- Po
- Jo
- Ndonjëherë

9.Në çfarë mënyre përfshihet komuniteti në implementimin e projekteve tuaja?

10.A e informoni komunitetin për rezultatet dhe të arriturat e projektit?

- Po
- Jo
- Ndonjëherë

11.Nëse po, çfarë forme të komunikimit përdorni me qëllim të informimit të komunitetit për rezultatet e projektit?


12.Në rastet kur keni nevojë për përkrahje shtesë (burime njerëzore) për realizimin e projekteve, në çfarë forme e siguroni atë?

- Përmes angazhimit të anëtarëve të organizatës në projekt
- Përmes angazhimit të vullnetarëve
- Përmes angazhimit të punëtorëve të rinjë në projekt
- Tjera:

SHTOJCA 3: LISTA E ORGANIZATAVE TË INTERVISTUARA

Emri i Organizatës	Regjioni
Create Foundation	Prishtinë/Priština
Chilproof / CIPOF	Pejë/Peć
Avoko	Prizren/Prizren
Ec ma Ndryshe	Prizren/Prizren
Shoqata Ekologjike "EKO-TREPÇA"	Mitrovicë/Mitrovica
Iniciativa për Zhvillim Lokal	Prishtinë/Priština
JEF Kosova (Federalistët e Rinjë Evropian)	Prishtinë/Priština
Network of Peace Movement	Gjilan/Gnjilane
Kosovo Advocacy and Development Centre	Prishtinë/Priština
OJQ Me dorë në zemër	Mitrovicë/Mitrovica
Organizata e Personave me Distrofi Muskulare	Mitrovicë/Mitrovica
Organizata Rinore Akti	Prishtinë/Priština
Qendra për Jetë të Pavarur	Pejë/Peć
Shoqata e Filozofëve të Kosovës	Prishtinë/Priština
Shoqata e Kultivuesve të Arrës dhe Lajthisë	Prishtinë/Priština
Shoqata Kombëtare e Diabetit (SHKDK)	Pejë/Peć
Euro Atlantic Association of Kosovo	Prishtinë/Priština
BEHAR	Prizren/Prizren
Klusteri i Industrisë së Metaleve dhe Energjisë së Ripërtitshme	Prishtinë/Priština
OJQ Aksioni kundër dhunës dhe ndertimi i paqes	Gjilan/Gnjilane
OJQ "Union Plus"	Gjilan/Gnjilane
Mileniumi I Ri	Prishtinë/Priština
Iniciativa Qytetare Skënderaj	Mitrovicë/Mitrovica
BIO NATYRA	Gjilan/Gnjilane
Qendra Kosovare për Hulumtime urbane PRO-Planning	Prishtinë/Priština
OJQ "Euro-Ekologët"	Pejë/Peć
Take Care about the Future	Mitrovicë/Mitrovica
Autizmi Flet	Prishtinë/Priština
Këshilli për Barazi dhe Edukim në Shoqëri	Prishtinë/Priština
Shoqata e Intelektualëve të Pavarur	Pejë/Peć
Rrjeti i OJQ-ve të Grave "Qeliza"	Pejë/Peć
Shoqata HardhFest	Prizren/Prizren
Women's Association Aureola	Prishtinë/Priština
iCHAT Centre	Prishtinë/Priština
Environmentally Responsible Action (ERA) group	Pejë/Peć
Ekovizioni	Prishtinë/Priština
Qendra për Këshillim dhe Përkrahje të Grave Dora-Dorës	Prizren/Prizren
Shoqata Kosovare për Celiakinë-CELIAKKOS	Prishtinë/Priština
OJQ "JETA"	Prishtinë/Priština
Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore	Prishtinë/Priština
Let's Do it Peja	Pejë/Peć

Femrat Aktive në Gjakovë	Pejë/Peć
Public Organisation for Local Initiatives and Supporters	Prishtinë/Priština
OJQ "Durmish Asllano"	Prizren/Prizren
Organizata Rinore "Hareja"	Mitrovicë/Mitrovica
Klubi Dëshira	Prishtinë/Priština
Provo Ndryshe	Prishtinë/Priština
OJQ për Riintegrimin e Grave të Riatdhesuara AMZA	Prishtinë/Priština
Make a Difference	Prishtinë/Priština
Shoqata për Emancipimin e Femrës ALMA	Pejë/Peć
OJQ Giving Hope	Prishtinë/Priština
Cult Club	Prishtinë/Priština
SH.H "Anton Qeta"	Mitrovicë/Mitrovica
K.F.A.N	Mitrovicë/Mitrovica
OJQ INNO	Pejë/Peć
Rinia Ndryshe	Prishtinë/Priština
Qendra për Emancipim Shoqëror-QESH	Pejë/Peć
RADC Learning Center	Mitrovicë/Mitrovica
Kosovar Youth Council	Prishtinë/Priština
Shoqata e grave fermere Krusha e Vogël	Prizren/Prizren
Community Development and Empowerment	Prizren/Prizren
The Youth Movement for Development for Development and Integration	Pejë/Peć
Iniciativa për Zhvillim të Qëndrueshëm	Mitrovicë/Mitrovica



European
Union
Kosovo